



Merita Isaki

*JETA ËSHTË NJË
DRAMË E VËRTETË*

Tetovë
2023

Merita Isaki

JETA ËSHTË NJE DRAMË E VËRTETË

Shkurt
2023

JETA ËSHTË NJË DRAMË E VËRTETË

Jeta, është ajo e cila të mëson se si të ecësh kundrejt ëndrave të tua. Ti rrëzohesh, por në të njëjtën kohë mësohesh edhe të rringrihesh përsëri, të përballësh me shumë sfida, por mëson edhe si ti kalosh ato. Mësohesh të tjerëve t'u dërgosh të buzëqeshur, edhe pse ti je e mërzitur. Të mëson ti shërosh plagët që ti shkaktoi jeta, dhe ashtu e plagosur vazhdon jetën përsëri. Kjo është historia e një vajze, e cila do të përballët me shumë vështërsi, por në fund do ia del edhe përkundër sfidave të ndryshme të jetës. Në vazhdim mund ti shfletoni faqet tjera të librit dhe të lexoni historinë e Samantës.

Në një Qytet të vogël të Amerikës jetonte një vajzë me emrin Samanta, ajo ishte shtatëmbëdhjetë vjeç, ishte shumë e bukur, kishte flokë të gjata ngjyrë të kaftë, sy të kaftë të cilët i shkëlqenin në diell. Ajo, atje jetonte me familjen e saj. Para pesë muajve ishin shpërngulur në Amerikë dhe jetonin në një lagje shumë të bukur, në një shtëpi plot harmoni. Ajo kishte shumë ëndrra, por ishte tip i mbyllur dhe si tregonte asgjë askujt. Preferonte që gjithçka të mbante brenda vetes, sekretet të mos ia tregonte askujt. Pikërisht historia për realizimin e ëndrës së saj fillon tani, me shumë sakrifica, shumë sfida dhe mund. Samanta do të përballët me shumë sfida në jetë, pikërisht këto sfida do ta mësojnë atë të qëndroj vetë në këmbët e saja. Samanta kishte kryer shkollën fillore e tani mëson në shkollë të mesme. Ajo jetonte e lumtur me prindërit e saj.

Samantën e donin shumë prindërit e saj. Por sekretet që mbanin prindërit, ishin se ato nuk ishin prindërit e saj biologjik, dhe pas shumë viteve kishin marrë një vendim që t'i tregonin edhe asaj. Tani më ajo ishte një vajzë e ritur. Ata që e birësuan Samantën quheshin Xhakarta dhe Leonardo. Ato nuk mund të kishin fëmijë prandaj kishin pranuar të përkujdeseshin për Samantën. Edhe pas kësaj qëndron një histori. Një ditë të bukur teksa Leonardo ishte duke biseduar me Xhakartën për vendimin që morën, që kur ti bëjë tetëmbëdhjetë vjet Samanta, t'i tregonin se e kishin birsuar. Ato ishin në kopsht, për fat të keq kishin haruar hapur derën e shtëpisë. Samanta i dëgjoi se çka po flisnin. Samanta shpejt vrapoj në kopsht dhe u kthye ka Xhakarta dhe Leonardo.

-Si mund të fshihnit një gjë të tillë nga unë kaq vite me rradhë nuk mund ta besoj-tha Ajo e tronditur.

-Unë nuk paskam një familje.

Samanta u mërzit aq shumë sa që doli nga shtëpia dhe vrapoi ka rrua.

-Leonardo bëj diçka, ndaloje.-tha Xhakarta

-Jo Xhakarta, lere duhet të qetësohet, kur të qetësohet do t'i tregojmë gjithçka.-tha Leonardo.

Ndërkohë Samanta me prindërit e saj kishin pesë muaj që ishin shpërngulur në Amerikë. Ajo nuk e njihte aq mirë vendin. Samanta duke vrapuar kishte kaluar disa lagje, kishte hyrë në një lagje tjetër dhe nuk e njihte vendin, aty afër kishte një park, shkoi e u ul atje nën hije të një peme.

-Domethënë qenkam e vetme në gjithë këtë botë të madhe, madje nuk paskam as familje. Nga vij unë, cilit vend cilës familje i përkas, nuk di asgjë -tha Ajo vetë me vete.

Samanta vazhdoi të fliste me veten por nuk e pa që kishte humbur, vallë a do mund ta gjej rrugën?

Shfletoni faqet tjera të librit

SHOQËRI, GJITHASHTU NJË RASTËSI

Filloi të erësohej e Samanta dëshironte të kthehej në shtëpi por nuk dinte rrugën. Aty afër, një vajzë kthehej nga shkolla, dhe ndërkohë rrugën për në shtëpi e kishte në atë anë, nga parku. Samanta e pa, dhe ndaloi.

-Më falni, mirmrëma.

-Mirmrëma,- ia ktheu,vajza e panjohur

-Mund t'iu pyes diçka?.

-Po sigurisht.

- Mos vallë e dini se ku ndodhet lagja numër 275, ka shumë pak kohë që jam shpërngulur këtu, e papritmas isha larguar pak dhe nuk munda të gjej vendin e të kthehem përsëri- tha Samanta.

-Po sigurisht, kjo është lagja e 5 pas saj, ejani se unë do të iu dërgoj.

-Ju faleminderit shumë. -Unë jam Samanta.

-Gëzohem, unë jam Rosita.

Gjithashtu edhe unë gëzohem që iu njoha, edhe pse rastësisht dhe në kësi kushtesh e në këto momente.

Rosita duke dërguar Samanten në shtëpi, bashkëbiseduan gjatë rrugës dhe u bënë mikësha.

-Ja arrite.

- Kjo është shtëpia ime,- faleminderit shumë Rosita, nëse dëshiron Babai im do të dërgoj deri në shtëpinë tënde, është natë, të mos friksohesh.

- Jo faleminderit unë nuk kam shtëpi, jetoj në jetimore,- ia ktheu Rosita.

-Vërtet, më fal shumë nuk desha të të lëndoj në plagë.

- Jo mos u brengos, ska problem.

-Të të them diçka Rosita... Unë sot kuptova që nuk kisha familje, isha e birësuar nga ato dy persona të cilët mendoja që janë familja ime.

-Paskëshim fatin e njejtë.

- Ashtu është. -Tani ti e din se ku jetoj unë, eja kur të duash dhe do të bisedojmë për problemet tona.

-Në rregull kur të kem kohë, shpresoj se do të vijë.

-Shihemi Samanta.

- Shihemi.

Ndërkohë, Leonardo dhe Xhakarta ishin shumë të brengour për Samanten, e kishin kërkuar por nuk e kishin gjetur. Në atë moment Samanta hyri kah dera.

-Bijë ku ishe u brengosëm shumë për ty-?

-Isha larguar pak si shumë pastaj fal Zotit një vajzë ma tregoi rrugën.

-Ska pse të frikësoheni, nuk jam e vogël, gjithashtu nuk jam vajza e juaj e vërtetë.

-Bijë mos i thua këto fjalë, je bija jonë e vërtetë.

Samanta ishte shumë e zemruar, shkoi tek dhoma e saj të pushoj.

Pastaj doli në ballkonin që kishte në dhomën e sajë. Shikonte yjet që shëndrisnin, sikur pëshpëritni e dëshiron ti thonin diçka.

-Ku është familja ime, ndoshta kam edhe ndonjë motër ose vëlla, ndoshta ata nuk i braktisën por mua, po pse vallë, ç'ju kam bërë, çfar zori kanë pasur, e shumë pyetje më vinin ndër mend në ato çaste.

-Çfar faji ka një foshnje e vogël,- tha Ajo dhe pastaj shkoi të flej e mërzhitur në dritën e hënës së plotë.

DITËLINDJA E SAMANTËS

Kaluan disa ditë që Samanta kishte kuptuar të vërteten për familjen e saj. Koha jashtë dukej e mirë. Sot kishte ditëlindjen. Ajo sot mbushi tetëmbëdhjetë vjet. Leonardo kishte shkuar tek dhoma e sajë, po e shikonte se si flinte. Papritmas ajo u zgjua.

-Mirmëngjesi bijë.

-Mirmëngjesi.

-Sot është ditëlindja jote.

-E di, sot kam bërë tetëmbëdhjetë vite që unë jam rritur me ju.

-Sot janë bërë tetëmbëdhjetë vite që familja ime e vertët më ka braktisur, apo jo-?

-Ne jemi familja yte e vërtet, Bija ime.

-Jo...nuk jeni, në fakt ju nuk keni asnjë faj, faji i juaj i vetëm është që nuk më keni treguar nga fillimi se kush jam unë në të vërtetë. Nuk dua të bëhem mos mirnjohëse për aq vite që jeni kujdesur për mua, që më keni dashur si fëmijën tuaj, ju falemenderoj shumë por unë nuk mund të vazhdoj jetën përsëri sikurse nuk di asgjë.

Dua vetëm një gjë nga ju...dua vetem të ma tregoni historinë time të vërtetë. Kësi lloj rastesh kam parë plot prandaj nuk mërzitem edhe shumë.

-Në rregull bijë-.

Leonardo i mërzitur doli nga dhoma. Pastaj, Samanta tha me vete; - Nuk desha t'iu mërzis juve, por vërtet nuk mund t'i them dikujt tjetër Nënë dhe Baba, nuk mundem të bëhem mos mirnjohëse për aq vite sa që më keni ritur, në shenjë respekti dua t'iu falemenderoj dhe dëshiroj t'iu kuptoj.

Samanta u bë gati dhe zbriti poshtë. Xhakarta po rregullonte mëngjesin.

-Mirmëngjesi bijë, urime ditëlindjen vajza ime bukur.

- Mirmëngjesi edhe juve, falemenderit për urimet e sinqerta.

Të gjithë së bashku u ulën në tryezë e po hanin mëngjesin.

-Bijë çfar dëshiron të të blejmë për ditëlindje ?

-Asgjë,falemenderit nga ana e juaj, thjeshtë dua të më tregoni të

vërtetën, por jo sot.

-Dëgjoni, unë jam shumë falemenderuese ndaj jush, më keni dhënë dashuri si dy prindër të vërtetë, m' i keni plotësuar të gjitha kushtet në jetë dhe jeni kujdesur për mua kaq vite, vendosa që si shenjë falemenderimi t'iu thërras vetëm Teta Xhakarta dhe Xhaxhi Leonardo. Shpresoj shumë që do të mund të më kuptoni, sepse unë nuk di asgjë për familjen time të vërtetë, a janë gjallë apo janë të vdekur, prandaj dua të di pak me shumë nga kjo temë.

-Të kuptojmë, nuk është e lehtë e dhe për ty e di.

-Çfar do bëjmë sonte për ditëlindjen tënde?.

-Nuk e di, mendoj që të hanim një darkë se bashku, do ta ftoj edhe Rositën, pra vajzën e cila me ndihmoi ta gjeja rrugën...

-Në rregull mundet, ftoje edhe atë .

Samanta më pas shkoi në shkollë, e pasi mbaroi mësimet shkoi në jetimore që ta merte Rositen në darkën e përbashkët të ditëlindjes së sajë.

-Përshëndetje Rosita.

-Përshëndetje Samanta, çfar po bën ti këtu?!.

-Erdha të të marr ty. Sot kam ditëlindjen, dëshiroj të vish edhe ti, madje do të prezantoj me familjen time.

-Në rregull atëher do të vij, por në fillim duhet t' i informoj përgjegjësit e mi.

Samanta dhe Rosita, shkuan në një restorant, në të cilin i priste Leonardo dhe Xhakarta.

-Mirmbrëma të gjithëve, unë jam Rosita.

-Mirmbrëma bij, pra ti je vajza që e ndihmove bijën time të kthehet në shtëpi, atë natë.

-Po ashtu ishte.

-Të faleminderit shumë, ta kemi për borxh një mirësi.

-Të gjithë do ndihmonin po të ishin në vendin tim, bëra atë që duhet bërë një njeri i mirë, dhe buzëqeshi.

Kështu biseduan gjatë tërë kohës, hëngrën darkën, pastaj e prenë dhe torten enkas për ditëlindje. Pastaj përsëri po bisedonin për gjëra të ndryshme.

-Rosita bijë, ku i ke prindërit, me çfar merren, mundet dhe ti njohim, prandaj pyeta?.

-Ashtu,unë.....jam në jetimore.

-Më fal shumë Rosita, nuk e dija.

-Nuk ka lidhje Xhaxhi, nuk ke pse kërkon falje, nuk e dije.

-Meqenëse, edhe Rosita e di që ju nuk jeni prinderit e mi të vërtet, mendoj që ju ta birësoni Rositën. Gjithsesi unë do të largohem të kërkoj familjen time të vërtetë, si thoni!?-pyeti Samanta.

- Nuk e di Samanta, do të mendohemi një herë.

-Në rregull, keni kohë plot për të menduar.

Pasi mbaruan darkën, Rosita u kthye përsëri në jetimore e ndërsa Samanta me familjen u kthyen në shtëpi. Ishte një natë e mirë që kaluan bashkë, por të shohim se çfar do të ndryshoj kur të kuptoj historinë e vërtetë Samanta.

HISTORIA E VËRTETË E PRINDËRVE TË SAMANTËS

Kaluan dy ditë nga ditëlindja e Samantës, kur prindërit e Samantës Xhakarta dhe Leonardo vendosen t'ia tregonin historinë e vërtetë të prindërve biologjik të saj.

-Samanta bijë, mendoj se sot është koha e duhur për ta dëgjuar e kuptuar historinë për prindërit biologjik.

-Po sigurisht, po ju dëgjoj!

-Ishte dimër, jashta bënte shumë ftohtë, binte shumë borë. Unë dhe Leonardo ishim brenda. Leonardo lexonte gazetën afër zjarrit, ndërsa unë isha duke punuar diçka në kuzhinë. Papritmas dikush trokiti në derë, ishin Frenk dhe Marilda, e në duart e tyre ishte ti, e mbuluar me një jorgan të vogël për fëmijë.

-Marilda me tha;- Ju lutem mereni këtë foshnje, për ndryshe do të vdes. Ne kemi shumë borxhe, dhe duan të na marrin vajzën tonë, ne duhet ta shpetojmë atë. Duam vajzën tonë ta birësoni ju. E di që nuk mund të keni fëmijë, po qe se e birësoni ju vajzën tonë, ne do jemi të sigurtë që vajza jonë do rritet në duar të sigurta. Kur të rritet mund t'ia tregoni të vërtetën, besoj se do të na kuptoj se e kemi braktisur për të mirën e sajë,- me tha Ajo, dhe tha tregoni që e duam shumë.

Samanta u ndje keq kur dëgjoj këto fjalë.

-Samanta a je mirë, e pyeti -Xhakarta.

-Po mirë jam, vazhdo të lutem.

-Kështu që ne të morëm ty brenda, e ata u zhduken sikur i mori era, ti ishte një foshnje dy muajshe, të buzeqeshte fytyra si një ëngjëll.

-Emrin tim

-Emrin tënd e kishin vendosur ato, në dorën tënde të vogël kishe një zinxhir të hollë me emrin tënd.

-A i keni parë më ato ?

- Jo, por e di që janë larguar për në Meksikë.

-A keni njohuri për adresën se ku kanë jetuar më parë ato.

-Po e dimë, ja këtu e kam në letër të shkruar.

Samanta mori letërën, dhe tha që të nesërmen do të nisej për Meksikë.

-Bijë nuk mund të shkosh vetëm.

- Jo, Unë dua vetëm të shkoj dhe nuk dua të vij askush me mua. Samanta shkoi në dhomën e saj. Pas pak çastesh i telefonoi Rosita. Ato biseduan një kohë për shumë çka, rreth atyre ditëve. Samanta i tregoi gjithçka asaj.

- Samanta mos fol kotë, edhe unë do të vij me ty.

-Jo nuk dua, do të shkoj vetë, thjeshtë mua më takon të gjej prindërit e mi biologjik.

-Po nëse përballesh me diçka të pritur, çfar do të ndodh atëher?. Nuk bën do të vij dhe unë me ty të të shoqëroj.

-Por si do të lejojnë ty të Jetimores që të largohesh nga shteti?

-Nuk e di, do trilloj diçka.

-Në rregull atëher.

- Mirë shihemi nesër.

Samanta mori dy bileta dhe të nesërmen do nisëshin në udhëtim. Në darkë u ulën dhe po bisedonin Xhakarta e Leonardo me Samantën.

-Bijë si do të shkosh vetëm atje, je ende e re, pa përvojë, është rrezik udhëtimi në ato vende?

-Mos u brengosni, do të vij dhe Rosita me mua;- tha Samanta.

-Në rregull atëher, iu përgjigjën të dy thuaje se për një herë.

Ishin të kënaqur se nuk do të udhëtonte e vetme. Samanta nuk fjeti atë natë fare, mendonte se a do të mund t'i gjente të gjallë prindërit e saj. Mëngjesi erdhi shpejt, koha ishte e bukur, fluturimi me aeroplan ishte në orën dy të drekës.

Erdhi koha që ato të largoheshin.

-Mirupafshim bijë, kujdesu mirë për veten- i thanë Xhakarta e Leonardo.

- Mos u brengosni do t'iu lajmëroj dhe sigurisht që do të vi përsëri këtu.

- Kjo është shtëpia jote, kur të duash mund të kthehesh, Bijë.

-Ju faleminderit, për gjithçka, ju dua shumë e dini këtë...mirupafshim.

Rosita dhe Samanta u larguan nga Amerika dhe aritën në Meksikë.

Ishte bërë vonë, ato ishin shumë të lodhura dhe vendosën që të pushonin pak në një Hotel. Të nesërmen të fillonin me hulumtimin e gjetjes së vendit ku banonin prindërit e saj.

Samantën e kishte zënë gjumi. Pa një ëndërr shumë të keqe, se si

prindërit e saj e lanë në jetimore. Ajo përgjerohej që ta merrnin përsëri, ndërsa ato për dore mbanin një djal të vogël.

Kur u zgjua ishte shumë e frikesuar dhe ishte djersitur.

-Samanta, mike çfar ke ?- e pyeti Rosita.

-Pash një ëndërr të trishtueshme, pash familjen time por fytyrat nuk iu dukeshin e ndërsa për dore mbanin një djalë.

-Nuk e di është thjeshtë një ëndërr, je fiksuar shumë pas kërkimit dhe gjetjes së prindërve.

- Ndoshta nga dëshira, mendimi dhe lodhja e ke, andaj ke pa atë ëndërr. Eja të flejmë, mos u shqetëso, pusho pak dhe nesër do të kërkojmë prindërit e tu, do ti gjejmë të jesh e sigurtë, do të jesh shumë e lumtur.

-Të faleminderit Rosita.

Samanta gjithë natën mendonte. Është interesante, sepse nuk mund ta kuptoj se si mund ta braktisin një foshnje të sapo lindur prindërit, do të doja ti përqafoja dhe të qëndorja bashkë me to. Ndonjëherë njeriu kur ndihet keq, i nevoitet vetëm një përqafim i dikujt që e do, e kështu mendon se të gjitha problemet zgjidhen kur të shpërndash lumturinë me njerëzit e familjen. Deri në mëngjes ajo vetëm këto gjëra mendonte, kështu e kaloi edhe natën...

NË KËRKIM TË MARILDËS DHE FRENKUT

Pas asaj nate të trishtuar që kaloi Samanta në Hotelin e vogël dy dhomëshe, përsëri vazhdoi hulumtimin për prindërit e saj. Samanta dhe Rosita u zgjuan herët në mëngjes, hëngrën diçka dhe dolën të kërkojnë për rreth.

- Samanta, tani ku do të shkojmë?....

-Mendoj të shkojmë tek ai fshati i vogël, nuk e mbaj mend emrin por e kam të shënuar në një letër, është këtu afër diku.

- Në rregull atëher të shkojmë.

Samanta dhe Rosita shkuan tek ai fshat. Kishte shumë lagje.

Vendosen që të ndaheshin. Samanta të shkonte në të djathtë, ndërsa Rosita në të majtë të fshatit. Samanta kërkoi shumë lagje, pyeti shumë njerëz por nuk gjeti asgjë. Gjithashtu Rosita shkoi të pyeste një grua e moshuar.

Ajo e ndaloi dhe i tha;- Bijë kë po kërkoni?

-Përshendetje Gjyshe unë po kërkoj Marildën dhe Frenkun, më thanë se jetojnë këtu.

-Po ti kush je,- e pyeti Gjyshja?!

-Unë jam një mike shumë e afërt, kam ardhur këtu për vizitë .

-Me që qenka ashtu, do të tregoj Unë. Çudi si nuk e paska kuptuar paraprakisht ardhjen tuaj, edhe pse jeni e afërmja e tyre.

-Nuk jemi pa për një një kohë të gjatë, prandaj.

-Në fund të lagjes është një shtëpi ngjyrë kafe, aty jeton Frenk me një djalë, që e konsideron si djalin e tij. Ato një herë u larguan nga Meksika, ka afro tre vite që janë kthyer përsëri.

- Faleminderit shumë Gjyshe. Po Marilda, ç'u bë me të?.

-Marilda ka vdekur, ka afro dy vite. Ajo gjithmonë më thoshte nëse pyet dikush për ne, thuaju që nuk na njeh, po me që qenke mike shumë e afërt, vendosa të të tregoj. Marilda ka qenë një grua shumë e mirë, por e mërziste fakti për të bijën, vetëm mua mi tregonte të gjitha brengat, më konsideronte si nënën e saj. Ajo është ritur pranë meje, e kam dashur si bijën time.

-Ashtu..., u mërzhita shumë për tetën Marilda, e kam dashur shumë,-
tha Rosita.

E faleminderoi Gjyshen përzemësisht, e u ndanë prej sajë.

Pastaj Rosita i telefonoi Samantës e i tha,-E gjeta familjen tënde.

Samanta u gëzua shumë e nuk pyeti as gjë tjetër, vetem se i tha më
dërgo adresen. Pas dhjetë minutash Samanta ishte aty.

-Ku janë prindërit e mi?...

-Samanta me vjen keq por... Marilda, pra nëna jote ka vdekur.

-Çfar ?

Mbeti e shtangur, i erdhi fare e pa pritur ky lajm. Samanta u mërzhit
shumë për këtë gjë.

-Të lutem Samanta, ende nuk e dimë a janë familja jote e vërtetë, apo
jo.

-Nuk mund ta besoj, i gjeta pas tetëmbëdhjetë viteve dhe më në fund
shoh që nëna ime paska vdekur.

-Samanta, unë mendoj që të shkojmë në Hotel, nuk je gati ta takosh
kështu e mërzhitur Babain tënd.

-Në rregull atëher, nesër do të vij këtu.

-Faleminderit shumë Rosita. Sa interesante qenka jeta gjithë ato
njerës në botë, dhe përsëri në fund ngel e vetmuar.

Kur aritën në Hotel, Samanta shkoi te dhoma saj dhe po bisedonte
me Rositën.

- E din Rosita, se çfar më brengos më së shumti, që as fytyren nuk ia
kam parë nënës sime, unë mund ta kisha takuar në rrugë por nuk e
kam njohur.

- Shiko Samanta, asgjë nuk është e sigurt, derisa ta pyesësh vetë
zoteri Frenkun.

-Mua më tha një Gjyshe, që nëna jote e kishte konsideruar si nënën e
saj. Mund të kishte folur për dikë tjetër, më beso.

-Nuk e di, do të shohim deri nesër, tek e fundit.

Të nesërmen Samanta vendosi të shkoj vetë t'i takoj prindërit, ashtu
bëri. U afrua te dera, i ra ziles, e në ndër kohë në derë doli një djalosh
i ri. Kishte trup mesatar, flokë të zeza, fytyrë të buzëqeshur, nuk
dukej si njeri i keq.

-Përrshëndetje, unë po kërkoj zoteri Frenkun, më thanë se kjo është

shtepia e tij.

-Përshtëndetje unë jam Mateo.

-Gëzohem, unë jam Samanta.

-Për çfar ju duhet juve, Xhaxhi Frenk?

- Duhet të bisedojmë diçka me të.

-Në rregull atëherë urdhëroni brenda.

Samanta hyri brenda e sigurt që do i gjente prindërit e saj, por edhe paksa e friksuar. Samanta pa një burrë jo shumë të moshuar, mbante syze, kishte shtatë të gjatë, i veshur me këmish dhe pantallona, ishte duke lexuar gazetën, i ulur në një karrige afër tavolnës. Ishte një dhomë e vogël, aty afër ishte një tavolinë, një kolltuk e aty afër ishte i ndezur edhe zjari.

- Përshtëndetje unë jam unë jam Samanta.

Burri që po lexonte gazetën pak sa u habit kur u prezantua Samanta.

-Përshtëndetje, ashtu...më falni, njihemi gjë?!?!.

-Po shumë mirë, madje jemi shumë të afërt. Samanta filloi ti tregonte historinë dhe si ariti ti gjente.

Frenku uli kokën, filloi të pëlotes, u mërzi shumë dhe tha,- E di, ke ardhur të kërkosh llogari prej meje, pse të kemi braktisur, por beso...

-Jo, Unë nuk kam ardhur t'iu kërkoh llogari juve, e ndërpreu Samanta.

-Unë kam ardhur që të bëhemi një familje, që të rribashkohemi.

Frenku përqafoi Samanten, të mos ishim të detyruar, nuk do të të kishim braktisur, e din se askush as një prind në botë nuk mund t'i braktis fëmijet e tij, por ishim të detyruar.

- E di Baba, po Nëna.. më thanë që ka vdekur.

-Ahh Bijë... më fal, por duhet të të them.... se Marilda vertetë vdiq nga dhimbja që s'te kishte parë ty, nga dhimbja që të lam ty, gjithmonë thoshte sikur ta gjeja atë..., e vriste ndërgegjia që të lam para tetëmbëdhjetë viteve.

Samanta u mërzi aq shumë, sa që as lotët dhimbjen s'ia ndalonin.

-Po ky djalë kush...

-Ky është si biri im, është gjashtëmbëdhjetë vjeç, quhet Mateo. Ka punuar me mua gati tre vite të plota.

- Një ditë unë me Marilden duke qëndruar brenda, i ra dikush derës, e kur e hapem derën, ishte një djalosh i vogël trembëdhjetë vjeç , ishte

shumë i uritur, kërkonte ushqim, dhe Nëna jote gjithmonë ndihmonte të gjithë fëmijët, e pranoi brenda. Samanta bisedoi shumë gjatë dhe erdhi koha që të shkonte. Babai i saj nuk e lejoi që të largohet nga shtëpia.

-Unë të kam gjetur pas shumë viteve dhe nuk mund të të lë të shkosh.

-Por e kam patjetër, sepse kam ardhur bashkë me shoqen time.

-Në rregull, por nesër ejani së bashku me shoqen tënde, dhe do të jetojmë së bashku këtu.

- Nuk e di se a do të pranoj Ajo, por në rregull do të shohim. Atëher shihemi nesër. Samanta ishte shumë e gëzuar, po ashtu edhe shumë e pikëlluar sepse nuk e kishte Nënë e saj. E megjithatë e gjeti Babain.

SHPËRNGULJA TEK FRENKU

Pasi Samanta e takoi Babain e saj të vërtetë, e informoi Xhakartën përmes një thirje telefonike.

-Përshëndetje Teta Xhakarta, doja t'iu informoj që unë nuk do mund të kthehem përsëri në Amerikë, sepse e gjeta familjen time, domethënë Babain tim, sepse Nëna ime kishte vdekur.

-Me të vërtetë, mu bë qejfi që ke gjetur familjen, ndërsa për nënën ngushllime.

- Faleminderit.

- Por Samanta të lutem na telefono, mos na haro, dhe kur të duash mund të vish të na vizitosh.

-Po sigurisht, mos u mërzitni, dhe faleminderit për kontributin tuaj që keni dhënë për mua.

- Mos fol ashtu Samanta, ajo është detyrë e çdo prindi ...

-Mirë u pafshim, shihemi së shpejti, mos haroni edhe ju mund të vini kur të duani këtu.

Samanta pasi mbaroi telefonaten me Xhakartën, filloi t'i bëjë rrobat gati, ndër kohë po fliste me Rositën.

-Rosita bëhu gati edhe ti, prej tash e tutje do të jetojmë me babain tim.

-Jo Samanta, unë mendoj që të kthehem përsëri në Amerikë, unë bëra punën time, duhet të kthehem në jetimore, nuk kam diçka që më përket mua në këtë vend, ndërsa për ty u gëzova shumë që e gjete familjen.

- Jo Rosita, unë nuk do të lejoj të shkosh. Këtu ka diçka që të përket ty. Jam unë, a nuk më the se jemi shoqe në ditë të vështira e të mira, unë u mësova me ty dhe nuk do të të lejoj të ikësh.

-Jo Samanta me të vërtetë duhet të shkosh. Por për ty mund të qëndroj edhe tre ditë këtu.

- Ohh Rosita, sa do doja që këtu të jetoje.

-Unë kam menduar diçka kur të kthehem në Amerikë nuk dëshiroj të kthehem në jetimore, mendoj të shkosh të jetoj me Xhaxhin Leonardo dhe me Tetën Xhakarta, gjithashtu edhe ato vetë janë.

-Sa mirë ke menduar, do të gëzohen shumë, më vjen shumë keq që i

lash vetë,- u përgjigj Samanta.

- Samanta, po ti çka do bësh me shkollën, ëndrra jote të shkosh në Milano. Çka u bë me të gjitha këto?!

-Unë ende se kam haruar ëndrren time, por tani dua të kaloj pak kohë me Babain tim, pastaj të studioj.

Ndërkohë duke biseduar të dy shoqet u bënë gati dhe shkuan te Frenku. Ai u gëzua shumë kur i pa, i ftoi brenda.

-Mirë se erdhe bijë.

-Përshëndetje baba.

-Po kjo vajza e mirë kush na qenka, mos është shoqja jote që më pate folur?

-Po Baba ajo është.

- Përshëndetje, unë jam Rosita.

-Përshëndetje unë jam Frenk.

-Më bëhet qejfi Xhaxha.

Ndërsa Mateo ishte djali i turpshëm, rrinte në prag të derës dhe nuk hyri brenda.

- Mateo bir, pse qëndron aty te dera, eja e njihu me Rositën.

Mateo u njoh dhe u bënë shokë me të. Në ndërkohë Samanta dhe Rosita shkuan në kuzhinë të përgadisnin darkën. Koha kishte filluar të ftohet sepse kishte ardhur vjeshta. Brenda në shtëpi ishte shumë ftohtë, sepse nuk e kishin nderur ende koftorin. Mateo shkoi të merr drunj. Pasi i solli Mateo drunjët, vajzat ndezën koftorin e filluan të përgadisnin darkën. Samanta dinte të përgadiste ushqime shumë të shishme, ndërsa Rosita bënte tortë shumë të shishme. Jashtë ishte errësuar e ishin nderur të gjitha dritat në fshatin e vogël të Meksikos. Ndërkohë vajzat mbaruan me përgaditjen e ushqimeve, brenda ishte bërë shumë ngrohtë nga koftori. Pastaj Samanta përgatiti tavolinën me Rositën dhe u ulën të gjithë në tryezë. Të gjithë u ulën dhe i shijuan ushqimet e Samantës dhe ëmbëlsirat e Rositës.

Frenk tha;- Këto janë gjellërat dhe ëmbëlsirat më të shishme që kam provuar deri tani. Të them të drejtën i paskëshi bërë ushqimet më të shishme se sa i bënte e ndjera, Marilda. Mateo qeshi, gjithashtu qeshën edhe të tjerët.

-Baba unë dua të shkoj te varetat, pra te vari i nënës sime.

-Në rregull bijë, do të shkojmë ndonjë ditë t'i vizitojmë varetat.

Pasi hëngrën darkën vendosën të luajnë pantonima. Mateo me Rositen, ndërsa Samanta me Frenkun. Tani e kishte rradhën Mateo. Mateo nuk dinte të luaj aq mirë, dhe të tjerët qeshnin, pastaj Mateo tha,- Rosita dil ti më mirë, sepse unë nuk di të luaj.

-Rosita buzëqeshi dhe tha,- në rregull.

-Rosita doli, bënte me shenja, por Samanta se kuptonte se çfar dëshironte të thotë !!. A dorzoheni i tha Rosita.

-Unë dorzohem,- tha Samanta .

-Atëher të tregoj unë.

Isha duke thënë familje e lumtur, por lumturia nuk përshkruhet as me fjalë. Të gjithë qeshën, kishte qenë shumë e lehtë por nuk kishin mundur ta gjenin. Në fakt askush nuk e kishte kuptuar lojën.

-Frenku pas lojës e shikoi Samanten e i tha,- Jam shumë i lumtur që të gjeta bijë.

-Ndërsa Mateo tha-, xhaxhi Frenk në fakt Samanta të gjeti ty, e jo ti atë.

Të gjithë qeshën, dhe tani ishte bërë me të vërtet një familje, një shtëpi e lumtur e gëzuar plot harmoni. Samanta shikoi të gjithë me rradhë dhe tha me vete,-"Është bukur të kesh një familje, është bukur kur dikush të jep shpresë kur ti dorzohesh, kjo është familja".

NJË SËMUNDJE E PAPRITUR

Kaluan disa ditë që Samanta ishte shpërngulur tek babai i saj.

Koha tani ishte bërë shumë e ftohtë, kishin filluar ngricat. Një ditë e ftohtë filloi dimri, filluan rreshtjet e para të borës në fshat.

Bora kishte zbardhuar gjithë vendet. Pikërisht atë ditë Babai i

Samantës u sëmur shumë keq, kishte temperaturë dhe dhimbje koke, ishte zbehur. Rosita kishte vendosur sot të shkonte në Amerikë, sepse ishin bërë ca ditë që ishte në Meksikë. Samanta e luti të qëndronte edhe dy ditë këtu, që ti ndihmonte rreth sëmundjes së Babait të saj.

Rosita pranoi, sepse i erdhi keq për babain e Samantës.

Shtëpia brenda ishte shumë e ftohtë dhe nuk kishin drunj për t'u ngrohur.

-Mateo a mund të shkosh të marësh ca drunj të lutem, sepse babai ka të ftohtë e është shumë i sëmur?.

-Sigurisht tani do shkoj, për Xhaxhi Frenkun unë gjithçka mund të bëj.

- Faleminderit shumë.

-Rosita faleminderit shumë që do qëndrosh me mua.

- Nuk ka gjë, ti je shoqja ime, ti je gjithçka që kam.

Ndërkohë Mateo solli drunjët, e Samanta shpejt e ndezi koftorin.

Dhoma filloi të ngrohet por gjendja e Frenkut sa me shumë keqësohej.

-Baba eja do të dërgojmë në spital, ke shumë temperaturë.

-Jo bijë.... jam mir mos u brengos.

-Jo nuk je mirë, duhet të shkojmë në spital.

Frenku kishte një makinë të vogël, por Samanta nuk dinte ta voziste.

-Rosita, a din të vozisësh makinën ?

-Po sigurisht di të vozis.

-Eja të dërgojmë babain në spital.

Kur e dërguan në spital, Doktori tha,- Do ti kaloj, nuk është diçka serioze, është një virus i kësaj stine, e i përshkruajti disa barna.

Por ju nuk e dini të fshehtën e kësaj sëmundje. Frenk kishte problem me frymarje asmë, gjithashtu kishte problem me zemrën.

Iu lut mjekut, që të mos u tregoj atyre. I kishin mbetur edhe shumë

pak kohë për të jetuar, dëshironte të i kaloj bashkë me bijën e tij.
Ditët kalonin dhe Frenku ishte pak më mirë.

-Samanta unë kam vendosur, nesër do të shkoj, ka që dy javë që jam këtu,- tha Rosita.

- Në rregull, por unë u mësova me ty, e këtë rradhë nuk do të ndaloj.

-Edhe unë u mësova me ty, por ja që duhet të ik.

-Samanta të lutëm mos i trego Tetës Xhakarta dhe Xhaxhait Leonardo, që do shkoj të bashkëjetoj me to, le të ua bejmë një surprizë.

- Po sigurisht, besoj se do të gëzohen shumë.

-Shpresoj.

Erdhi e nesërmja, Rosita po shkonte.

-Erdhi koha që të shkosh.

-Mirupafshim Rosita, përshëndeti nga unë Xhakartën dhe Leonardon.

-Po sigurisht dhe e përqafoi.

-Shihemi Xhaxhi Frenk, e kur të shërohesh eja me Samanten dhe Mateon të na vizitoni. Shpresoj të shërohem dhe do të vijmë gjithësesi të iu vizitojmë.

- Mateo shihemi, edhe ti je i mirseardhur, tani më je shoku i jonë, je pjesë e familjes.

-Sigurisht do të vij, faleminderit .

Të gjithë u përshëndetën. Samanta mbeti e vetme me Babain dhe Mateon. U mërzit për shoqen e saj, e ndjente veten të vetmuar. Por në mbrëmje ato vendosen të shkonin diku jashtë të tre, vendosen të hanin darkë diku jashtë në ndonjë restorant. Ashtu dhe vepruan. Kaluan shumë bukur atje, sepse jashtë dukeshin reshjet e borës që të jepnin një shpresë, dhe lumturi.

VDEKJA E FRENKUT, NJË VETMI PËR SAMANTËN DHE MATEON

Ditët kishin kaluar, kishte ardhur dimri i ftohtë. Jashtë binte borë shumë bukur, ndërsa Frenk i sëmur shikonte nga shtrati i tij. Në një pas dite Samanta vendosi ta thëriste Rositen në telefon.

-Rosita përshëndetje, si je, a arite në Amerikë?...

-Mirë, po kam aritur Samanta, Xhaxhai Frenk a u shërua?...

-Jo, është me shëndet njejtë sikur ishe ti këtu.

-Po ti çfar bëre a shkove tek Xhakarta dhe Leonardo, a u gëzuan kur të panë?.

-O po shumë, edhe pse e dinin pak a shumë këtë gjë. Ja jemi duke u bërë gati për udhëtim, do të shpërngulemi në një shtëpi tjetër, sepse te shtëpia që jetojmë nuk punojnë termot për ngrohje, është shumë ftohtë.

Samanta i përshëndeti të dytë. U gëzua shumë që shoqja e saj u bë me një familje të mrekullueshme. Pasi bisedoi me Rositen, Samanta bëri një supë dhe ia dha babait të saj, të hajë. Ditët kalonin, Frenku çdo ditë e më shumë bëhej më keq. Mateo shumë friksohej që mos të vdiste Frenk, që për të ishte si baba, por këtë nuk ia thonte Samantes, të mos mërzitej.

-Babi si je, a je me mirë, a dëshiron diçka?.

- Oh mos u lodh bijë unë do të vdes.

- Baba mos fol kështu.

-Jo bijë e ndjej, por më vjen keq për ty sepse tani sa më gjete, e shumë shpejt do më humbasësh.

-Jo babi, ti do të shërohesh, madje shumë shpejt.

Frenku gjithmonë thoshte kështu, por në një natë të trishtuar frynte një erë e fuqishme jashta. Frenku ishte shumë keq gati duke vdekur. Jashta kaploi një stuhi e madhe ndërsa Samanta sdinte çfar të bënte. Frenku atë natë e thiri Samanten dhe e i tha;- Bijë mos u mërzit ska shpresë dhe dua që pasi të vdes këtë shtëpi t'ia lë Mateos. I gjori nuk ka as familje as shtëpi.

-Mos fol kështu Baba, ne të tre do jetojmë të lumtur në këtë shtëpi. Samanta tinësisht qante nga fjalët që i tha i ati, frigësohej se nëse

vdes babai çfar do bënte e vetme, e ku do të shkonte.

Kur u zgjuan në mëngjes, Samanta shkoi të shihte babain e saj si çdo ditë. Hapi derën, u afrua te koka të shihte babain mos vallë po fle.

-Baba zgjohu është koha e barnave!.

Frenk nuk lëviste madje nuk merte as frymë...

- Babiiii...të lutem hapi sytë, të lutem mos bën shaka, të lutem mos bën kështu, të lutemmm, Zot mos e merr atë nga unë.

-Mateoo.....babi...im.

Mateo përqafoi Samantën.

-Në rregull mos qaj.

-Nuk u bë as një...muaj që e takova...si mund.

Të nesërmen bëhej varimi. Pasi u krye varimi, Samanta thëriti Mateon.

-Mateo unë kam vendosur që të largohem nga këtu, madje nesër, nuk mund të përballoj faktin që për një muaj gjeta familjen, po ashtu dhe e humba. Shtëpinë do ta lë ty, kjo është shtëpia yte, mund ta krijosh familjen tënde këtu. Kjo ishte dëshira e fundit e babait para se të vdiste.

-Jo Samanta, nuk mund ta pranoj një gjë të tillë, kjo shtëpi të takon ty.

-Mateo të lutem pranoje, kjo ishte dëshira e babait.

-Ohhh.. Samanta, në rregull faleminderit shumë, por ta dish kjo derë është e hapur gjithmonë për Ty.

-E di djalosh eja këtu, mos u mërzit. Në rregull faleminderit që pranove.

Samanta bëri rrobat gati dhe të nesërmen do të nisej që të realizonte ëndërn e saj, diku larg, larg në një kontinent tjetër.

UDHËTIMI PËR NË MILANO

Të nesërmen Samanta u zgjua herët dhe po nisej për udhëtim.

- Mateo, erdhi koha që unë të shkoj.

-Po ku do të shkosh?

- Nuk e di as vetë Mateo, vetëm e di se jam duke shkuar në udhëtim.

-Ki kujdes, ruaju nga njerëzit e këqinj. Kur të kesh ndonjë problem mund të më thërrasësh mua.

-Më konsidero si motrën tënde të madhe.

-Gjithashtu kujdesu për veten.

-Mirëmbetësh i tha Samanta.

Samanta po shkonte në Milano. Nga mosha dymbëdhjetë vjeçare Samanta kishte ëndëruar dhe me shpirt kishte pritur udhëtimin e saj. Në njërën anë Samanta ishte e pikëlluar që humbi babain e saj, e nga ana tjetër ajo ishte e lumtur se po e realizonte ëndrën e saj.

- Mos vallë mora një vendim të shpejtë, u desh të prisja një javë e pastaj të nisja rrugëtimin. Samanta ishte pak sa e shqetësuar, sepse kur të shkonte në Milano do ishte krejt e vetme. Samanta hypi ne aeroplan, por këtë herë kishte frigë sepse me vete se kishte Rositen.

Samanten e kishte marrë malli shumë për Rositën, Leonardon, Xhakartën. Kur i kujtoheshin momentet që kanë kaluar bashkë me prindërit dhe shoqen e saj, tha me vete;- Pse të mos shkoj

ata ti takoj, pastaj të udhëtoj për në Milano. Ashtu dhe veptoi.

Samanta shkoi në Amerikë. Rosita ia kishte treguar adresen e shtëpisë së re. Samanta kur kur ariti te shtëpia e re në Amerikë, ishte vonë në mbrëmje, trokiti në derë.

-Erdha, erdha bërtiti një zë nga brenda.

Kur pas pak kohe te dera u shfaq Xhakarta, hapi derën, e u habit.

-Bijë Samanta, mirë se erdhe, u gëzova shumë që ke ardhur, eja brenda.

- Mirë se ju gjeta, ta gëzoni shtëpinë, qenka shumë e bukur, paska pamje të bukur nga deti.

-Faleminderit, eja brenda.

Kur hyri brenda Samanta, pa Leonardon duke lexuar gazetë e Rositën duke lexuar një libër.

-Samanta.. mirë se erdhe, na gëzove shumë.

-Mirë se iu gjeta Xha Leonardo.

- Samanta shoqia ime, mirë se erdhe, po Xha Frenku ku është, a ska ardhur me ty.

-Mirë se ju gjeta Rosita....

-Babai im.....vdiq....domethenë ka dy ditë që nuk gjendet në mesin tonë.

- Ka qenë i sëmur nga zemra dhe nuk ka dashur të më mërzis,- tha Samanta, dhe mezi e mbante veten të mos qante.

-Oh, më vjen shumë keq Samanta, ngushllime, ti mos u mërzit, nuk je e vetme, na ke neve, tani do jetojmë të lumtur të gjithë. Rosita na tregoi gjithë ngjarjen,- tha Leonardo.

-Jo unë nuk do mund të jetoj këtu, të them të drejtën unë u nisa për në Millano, por më kishte marë malli shumë t'iu shihja e vendosa së pari të vij këtu, e pastaj të shkoj.

-Po çka do bësh në Millano Samanta, mos vallë je duke shkuar për atë që më ke treguar?.

-Po unë do të shkoj atje, e do jetoj përgjithmonë. E dini pse unë nuk ia kam përmendur, e dini Xhaxhi Leonardo kur ishin Krishtlindjet, unë atëher kisha dymbëdhjetë vjet, e ti më the të mendoja një dëshirë, të shkruaja në letër dhe ta gropoja në kopësht, e dini çka mendova... Unë ëndëroja të vizatoja e pastaj të shkoja në Millano të hapja firmën time. Kjo dëshirë ende nuk është shuar, do shkoj ta realizoj atje.

-Me të vërtetë bijë, u gëzuam shumë.

-Samanta s'mund ta besoj, u gëzova shumë,- tha Rosita.

-Shpresoj që dhe ti ta realizosh ëndën që ke,- tha Samanta.

Kështu biseduan gjatë. Erdhi mbrëmja, të gjithë u ulën në tryezë. Xhakarta kishte përgaditur shumë ushqime të shishme, sigurisht sepse ajo ishte kuzhinierë, ndërsa Leonardo merej me riparimin e makinave.

-Samanta çfar u bë me Mateon, i shkreti me siguri ka mbetur në rrugë?,-tha Rosita.

-Jo mos u mërzit, babai para se të vdiste...domethenë...më la amanet që t'ia dhuroj atij shtëpinë, e unë ia dhurova më shumë dëshirë shtëpinë e nuk e lash në rrugë, atë.

-Shumë mirë paske vepruar,- i thanë Samantës.

-Gjithashtu as unë s'kam shumë kohë, do qëndroj edhe nesër e pastaj do të shkoj.

- Qëndro sa të duash , kjo është edhe shtëpia jote.

-Faleminderit, gjithashtu të lumshin duart për ushqimet e shijshme.

-Të bëfshin mirë bijë, por ti s'hëngre asgjë, nuk bën kështu, provo diçka.

-Në rregull.

Pasi hëngrën darkën, Samanta rezervoi biletën për pasnesër. Dy ditë që patën në disponim i kaluan shumë bukur, shëtitën, kaluan një kohë të bukur bashkë, si familje. Ditët kaluan shpejt, koha erdhi që Samanta të largohej. Të nesërmen Samanta shkante. Të gjithë u zgjuan herët për t'u përshëndetur me të.

-Faleminderit për gjithçka, nuk do të haroj kur atë që keni bërë për mua.

- Mos fol kështu bijë, mund të vish kur të duash, kjo është shtëpia jote,- i tha Xhakarta.

- Samanta, ti je shoqja dhe motra ime, shpresoj të kalosh mirë. Më telefono sa herë që të duash.

-Edhe ti gjithashtu Rosita, shpresoj të takohemi shumë shpejt.

-Samanta merri këto para, do të duhen për vendin që do të banosh!

-Por Xha Leonardo, këto janë shumë.

-Jo nuk janë, kur do të kesh nevojë do të duken pak. Kur do të kesh nevojë për ndihmë të lutem na lajmëro.

- Në rregull faleminderit, gjithashtu edhe ju më lajmëroni ndonjëherë e më tregoni për shëndetin tuaj.

Samanta ariti në aeroport, u përshëndet me të gjithë e më pas filloi rrugëtimin për në Millano. Para Samantës do shfaqeshin shumë rrugë të panjohura, por gjithashtu ishte drejt hapave të realizimit të ëndrës së saj. Kur ariti në Millano u mahnit nga bukuria e vendit. Ishte natë dhe ishin ndezur të gjitha dritat, e ambienti shëndriste sikurse të ishte ditë. Leonardo dhe Xhakarta i kishin dhënë Samantës para, e ajo me ato para bleu një banesë të vogël, tek e cila do mund të jetonte gjatë kohës që do punonte. Banesa ishte e vogël, por shumë e bukur dhe e re. Samanta ishte lodhur, ra të flej. Ajo edhe për kundër se kaloi gjithë ato vështërsi të jetës, kur nuk tha u lodha ose u dorëzova, është

vajzë e fortë, e përballoi gjitha sfidat e jetës e do ti përballojë edhe shumë sfida tjera. Ne vazhdim do të shihni aventurat gjatë rugetimit të saj, për më shumë shfletoni faqet tjera të librit. :)

GJITHÇKA NGA FILLIMI

Kishin kaluar tri javë që Samanta ishte shpërngulur në vendin e ëndrave të saj. Ajo tani më u mësua me jetën, krejtë e vetme. Tani ajo jetën e saj e filloi prej fillimi në një vend të ri. Nesër mendoj që të shkoj të aplikoj për punë,- thoshte me vete, por studimet sidoqoftë do t'ia bëjmë disi. Të nesërmen shkoi te një firmë për t'u punësuar, por për fat të keq se pranuan. Samanta u mërzit shumë, por kur nuk u dorëzua, vazhdoi të luftonte për ëndrën e saj. Samanta gjithmonë thoshte,- Përballova shumë gjëra, do e përballoj edhe këte dhe kështu vazhdonte çdo ditë. Samanta tani kishte më shumë obligime, të gjitha gjërat duhej t'i bënte vetë. Kështu vazhdoi deri sa një ditë shkoi të provoj përsëri fatin, por këtë radhë ndodhi diçka ndryshe. Samanta shkoi të kërkoj të punësohej tek një firmë me emrin Design COLECION, aty ishte një zonjë, e cila e udhëheqte firmën, quhej Miranda, ishte një grua elegante, një grua e bukur, dukej shumë serioze, ishte e veshur me kostum pune, mbante syze, ishte shumë e mirë dhe ndryshe nga të tjerët.

-Përshëndetje zonjë unë jam Samanta.

-Përshëndetje, mund të ulesh.

Samanta filloi t'ia tregoj koleksionin e saj. Kur i pa koleksionet, punimet e Samantës, Ajo tha - Janë shumë të bukura. E ke kryer fakultetin, apo ke shkuar në ndonjë kurs të dizajnit?

-Jo zonja Miranda as njërën e as tjetrën, unë nuk kam kryer fakultet e as nuk kam ndjekur ndonjë kurs të ngjajshëm nga këto, unë e kam kryer vetëm shkollën e mesme, nuk kisha mundësi të vazhdoja edhe fakultetin.

-E kuptoj atëher, ta kuptosh më mirë do të them kështu, firma e jonë Design Collection për të gjithë talentët si ti, u mundëson bursa për të shkuar në shkolla private për dizajn, e këtë ta ofrojmë edhe ty.

-Çfar, me të vërtet..!!? ishte shtangur nga gëzimi.

-Po me të vërtet.

-Ja mere këtë letër, këtu është adresa e shkollës, dhe nese ia jep këtë letër drejtoreshës së shkollës së dizajnit, do të pranojnë që nesër, nese aplikon, e pasi ta kryesh fakultetin mund të të pranojmë në punë këtu

në këtë firmë, pse jo edhe si dizajnere e firmës.

-Me të vërtetë, faleminderit shumë zonja Miranda, shpresoj që një ditë t'ua shpërblej me të mirë.

- Më çudit fakti që ka vetëm një ditë që më njohet, dhe menjëher më shpërblyet.

-Njeriu vërehet nga puna, dhe puna që kishe bërë ti ishte perfekte, ishte një punë e pastërt e punuar me dashuri, fokusim në punë. Nëse të gjithë ato që e pëlqejnë dizainin me gjithë zemër dhe bëjnë punën si ti, i ftoj të aplikojnë këtu në këtë firmë.

-Faleminderit shumë,- tha Samanta, doli nga firma e shkoi në shtëpi e lumtur sepse edhe do bënte fakultetin, edhe do diplomonte, edhe për kundër faktit se i kishte mbetur edhe një vit për të kryer shkollën e mesme. Ajo ishte e lumtur përsëri. Që të nesërmen ajo do fillonte me bursën që ia kishte ofruar nga zonja Miranda. Samanta vendosi ti telefononte Xhakartës dhe të tjerëve për t'u treguar për shkollën. Ashtu edhe veçroi.

-Përsëritje Xhakarta dhe Leonardo, si jeni, dukeni mirë nga zëri!?

-O faleminderit bijë, mirë jemi, ti si je, mirë dukesh dhe shumë e lumtur.

- Po ashtu është, ju lajmrova për t'iu treguar se kur shkova të punsohem në firmën e dizainit, që më parë iu tregova, aty ishte udhëheqësia e firmës, e cila quhej Miranda. Ajo kur i pa koleksionet, më pyeti;- A e kam kryer fakultetin.

-Unë i thash jo.

Ajo vendosi të më jepte bursë që të mund të vazhdoj studimet, e pastaj unë të punsohem në firmën e saj.

-Samanta shumë u gëzuam, të lumtë bijë, jemi krenare me ty, je shumë e talentuar.

-Faleminderit, po Rosita ku është, a nuk është me ju, ku ka shkuar, mos vallë është e sëmurë?

-Jo, ka shkuar në shkollë, edhe një orë do të vij.

-Shumë mirë, tregoni edhe asaj kur të kthehet.

-Në rregull mos u brengos, mbetësh mirë.

-Edhe ju gjithashtu.

Pasi Samanta bisedoi me Xhakarten dhe Leonardon, filloi të bëhet gati, për nësër. Kishte shumë emocione, por ishte edhe shumë e

lumtur që ëndrra e saj po realizohej.

-Qenka interesante, u emocionova por skam kuj t'i tregoj se si ndjehem. Vërtet jam e gëzuar, ka gati një muaj që kam humbur babin. Më mungojnë të gjithë, e kisha patjetër të vija këtu. Njeriu ndjehet i vetmuar kur sheh se ska kujt ti tregoj gëzimin e tij, qenka e vërtet. Samanta ra në gjum më herët sepse nesër fillonte dita e bukur në shkollë. Edhe ne duhet të behëmi si Samanta. Ajo e deshi dizajnin me gjithë zemer dhe ariti ta realizoj ëndrën e saj deri diku. Edhe pse kaloi shumë vështërsi ajo përsëri u përball me të gjitha këto dhe ia doli. Samanta është një shembull për të gjithë ne. Ajo me këmbguljen dhe vendosmërinë e saj jep një mesazh, nëse dëshiron diçka me gjithë zemër, të besosh ëndrrën, ta realizosh atë. Ajo zgjodhi që ti lë edhe njerzit më të dashur, thjeshtë për të punuar për të ardhmen e saj.

DITA E PARË NË FAKULTETIN E DIZAINIT

Samanta u zgjua herët dhe u bë gati për në fakultet, kishte frigë se a do mund t'ia dilte, kishte emocione, por një brengë e madhe e mundonte më shumë. Ajo thoshte me vete - A do të kem respektin e studentëve tjerë, vallë a do kem ndonjë shoqe për të bashkëjetuar e bashkëpunuar me të, mike të vëtetë me të cilëndo i ndajmë të mirat e të këqijat së bashku.

Erdhi koha për të shkuar në fakultet. Kur ariti te Fakulteti, Samanta veproi sipas udhëzimit të zonjës Miranda, nxori letren e ia dha Drejtorit të shkollës. Ai menjëherë e pranoi, e ia tregoi klasën se ku do mësonte. Kolegët, Samanten e pritën shumë mirë, madje nje vajzë u bë shoqe e ngushtë me të. Ajo quhej Mia, e cila ishte një vajzë shumë e mirë, e sjellshme e bukur, me gjithatë gazmore.

-Mirdita, mirë se erdhe në klasën tonë. Unë quhem Mia.

-Përshëndetje, mirë se ju gjeta. Unë quhem Samanta.

-Më bëhet qejfi, eja ulu me mua në bankë, unë jam vetëm.

-Edhe mua më bëhet qejfi, mundet, faleminderit.

Samanta pasi u ul u prezantua me shumë vajza por të gjitha flisnin Italisht. Samanta dinte të fliste edhe Italisht edhe Anglisht. Italisht nuk dinte shumë mirë sepse sapo kishte ardhur në Milano, kështu që kuptohej më shumë me Mien. Të gjithë e përshëndetën Samantën, vetëm një vajzë me emrin Kanita nuk e përshëndeti.

Samanta iu afrua ta përshëndet, por kolegët e klasës i thanë që të mos përshëndet me të. Ajo është shumë e keqe, mendon se është e pasur, është më e mirë nga të gjithë dhe vetëm na ofendon.

-Është turp, të gjithë i përshëndeta, vetem atë jo.

-Në rregull ti e din, i tha njëri nga kolegët.

-Përshëndetje, unë jam Samanta, jam e re tash sa kam ardhur në këtë shkollë.

Kanita që ishte e vrazhdë dhe e keqe, tha- Ç'më intereson mua, bëj çfar të duash, e mos më përshëndet edhe një herë, varfanjake.

Samanta u mërzit shumë, nuk tha gjë, u ul tek vendi i saj.

-A të tham mos shko ti flasësh asaj. Ajo kështu sillet me të gjithë, mos u mërzhit për fjalët që ti tha sepse me gjithë kolegët ashtu vepron,- tha Mia. Vepron njejët si fëmijë.

-Jo nuk u mërzhita, thjeshtë u nevikosha. Unë si bëra gjë dhe ajo menjëher me injorancë ma ktheu.

-Në rregull lere atë, na trego diçka rreth vetes tënde.

-Sdi çfar t'iu them, historia ime është shumë e gjatë.

-Në rregull na rrëfe shkurt disa sekuenca të jetës, ne do të dëgjojmë ,- tha Mia.

-Mirë po ia filloj nga Amerika. Unë katër ose pesë muaj jetova në Amerikë, pastaj pas Amerikes vendosa te vija këtu. Ëndra ime ishte të vija këtu dhe të bëhem një dizajnere e famshme.

-Po prindërit çfar thanë kur ti vendose të vije këtu?.

-Prindërit...ato një herë kundërshtuan, por pastaj e panë qe isha shumë e vendosur për realizimin e ëndrrës sime, dhe më lejuan të vija këtu.

-Kur erdha këtu doja të punoja, pra t'ia shisja dizajnet e mia firmës Design Collection, por Drejtoresha e firmës me dha bursa për ta kryer Fakultetin e dizajnit këtu. Më tha se të gjithve u jepet bursa.

-Po ti fakultetin se ke bërë?.

-Jo,- tha Samanta, prandaj kam ardhur këtu.

Në ndërkohë në ligjeratë erdhi Profesori i vizatimit. Samanta u prezantua.

-Përshëndetje, jam Samanta, jam studente e re në këtë klasë.

-Ashtu mirëse na erdhe atëherë. Tema e sotme është përshkrimi i natyrës, çka shihni duhet ta vizatoni si për shembull, natyra e qetë e stinës që jemi ne.

-Po ku ta shohim ne si është jashtë, ne jemi brenda në klasë, bërtiti Kanita.

- Kanita, së pari ule zërin sepse unë jam ligjëruesi yt, dhe së dyti do ta paraqitni natyrën ashtu siç e ke parë para se të futesh në ligjeratë. Për çfar janë dritaret besoj se duket natyra edhe nga dritaret, apo jo të nderuar?.

-Po thanë të gjithë një zëri, ndërsa Kanita shikonte të gjithë me zili. Ishte një vajzë pa sjellje dhe respekt. Dhe me të vërtet, nga dritaret natyra dukej shume bukur. Kishte rënë bora dhe kishte mbuluar

gjithë vendin me ngjyrë të bardhë. Drunjë, degët e së cilëve ishin të rënduara nga bora. Qielli i kaltërt, pra gjithçka që kishte zbukuruar kjo stinë e bukur. Të gjithë filluan me punën dërsa Kanita jo, sdinte si t'ia niste. Të gjithë njëherë e filluan vizatimin me laps që të mos bënëin gabim, ndërsa Samanta filloi menjëher me ngjyrë.

Profesori, i cili quhej Xhejson, i tha Samantës, -Shihet talenti yt, ke filluar shumë bukur ta bësh natyrën, qenke shumë talente dhe i nevoiten të gjitha shkollave një talente si ti.

- Faleminderit profesor, unë e pelqej pikturën dhe e bëj me gjithë dëshirë.

-Kjo nuk është e mirë por fantastike.

-Faleminderit që mendoni ashtu.

- Po ti Kanita çfar po bën, pse nuk ke filluar të pikturosh?.

-Nuk di si ta filloj.

-Në rregull, unë do të ndihmoj ta fillosh dhe pastaj ti vazhdoje vetë.

-Kanita, sjellja jote më parë s'më pelqeu.

-E di profesor, isha pak me nerva dhe u shpreha keq me ju, më falni.

- Në rregull, ska gjë.

Në ndërkohë Profesor Xhejsoni e kishte filluar shumë bukur ta bëjë pikturën,- ja tani vazhdo vetë ta bësh.

-Faleminderit profesor do vazhdoj vetë.

-Në rregull atëherë.

Pastaj profesori Xhejson shkoi edhe te studentët tjerë, shkoi edhe te Mia. Ajo ishte një piktore e vërtetë, ajo vizatonte shumë bukur.

-Mia shumë bukur je e fokusuar në punë më pelqen stili yt i punës.

-Faleminderit.

Profesori shkoi edhe të studentët tjerë dhe të gjithëve u komentonte për punën që e bënin.

-Sa më shumë pozitivitet aq më mirë,- tha Profesori.

Mbaroi ligjerata, e profesori tha,- Vazhdoni përfundoni dhe veni në shkaf. Ishte pushimi i gjatë, të gjithë kolegët shkuan të blejnë ushqime ndërsa Samanta nuk shkoi.

-Samanta eja është pushimi do të blejmë diçka për të ngrënë,- tha Mia.

-Jo Mia, faleminderit dua ta përfundoj pikturën pastaj nëse kam kohë do të vij.

-Në rregull ti din.

Ndër kohë Samanta e përfundoi pikturën, i doli aq e bukur sa që kur e shihje, mendoje se e ka pikturuar një piktor profesional. Tani mund të shkoj në pushim, vendosi pikturën në shkaf dhe sa doli, zilja ra për të hyr brenda, pra kishte përfunduar pushimi. Në rregull ska lidhje herën tjetër ndoshta.

Këtë orë kishin me profesoreshen e dizajnit, Profesoresha Xhesika. Të gjithë e përshëndetën Profesoreshen.

-Përshëndetje, paskëshim një studente të re.

-Mirdita Profesoresh, Unë jam studente e re në këtë klasë, quhem Samanta.

-Gëzohem, mirëse na erdhe Samanta, shpresoj të të kenë pritur mirë koegët tjerë.

-Po sigurisht më pritën shumë mirë.

Në rregull atëherë fillojmë me orën. Për sot keni të bëni një koleksion për këtë vit, keni një muaj kohë, pastaj në fund të Vitit të Ri do ti prezantoni para mysafirve koleksionet tuaja, mund të filloni prej sot. Të gjithë filluan të krijojnë. Mbaroi edhe kjo ligjeratë, disa profesor nuk kishin ardhur. Studentët shkuan në shtëpi. Samanta kaloi shumë mirë që në ditën e parë, dhe të gjithë e pëlqyen. Më pas shkoi në shtëpi, ishte lodhur aq shumë sa që e zuri gjumi në dyshemë. E pra kjo është vetëm fillimi, nuk duhet të jetë lodhur që në ditën e parë, në vazhdim do t'i shihni aventurat e Samantës në fakultet.

MIKESHA E RE E SAMANTËS

Ditët kalonin shpejt, koha ishte e ftohte. Dimri e kishte zbukuruar shumë Milanon me ngjyrën e bardhë. Ndërkohë Samanta ishte duke fjetur, u dëgjua një zhurmë jashta, ishte pas ditë. Samanta kur dëgjoji zhurmën shpejt u zgjua.

-Çfar u bë, çfar është kjo zhurmë. Samanta u frigësua, kur doli jashta...ç'të shihte. Ishte një mace e cila e kishte këmbën e lënduar, mjaullinte, e i binte derës që të hyj brenda.

-O macë e vogël çfar ke kështu??.Samanta kur e pa që macja ishte e lënduar, e mori brenda, i erdhi shumë keq kur e pa në atë gjendje. Samanta mori macen ia lidhi këmbën, pastaj i bëri një krevat të vogël dhe e vendosi aty, por macja vazhdonte të mjaullinte.

-Mace e vogël çfar ke ??? Ti je e uritur, si nuk mu kujtua kjo gjë. Samanta mori një tas e mbushi me qumësht dhe ia vendosi macës, por nuk shkon kështu mace e vogël, ti prit këtu do të kthehem shpejt. Samanta mori pallton dhe u nis për në market, e kishte shumë afër shtëpisë, bleu ushqim për mace dhe gjëra tjera që i nevoiteshin. Samanta e pa një shtëpi të vogël për mace, ishte shumë e bukur. Mendoj ta mer edhe këtë, ka vend, do e nxë brenda në shtëpi. Samanta mori dhe atë, i pagoi dhe shkoi në shtëpi. Kur ariti në shtëpi, macja e kishte përfunduar qumshtin, kur hyri Samanta në derë macja edhe pse kishte këmben e lënduar, vrapoi drejt saj.-

- O prit do më rrëzosh shko ulu te shtrati yt, macë e vogël. Macja sikur e kuptoi se çka i tha Samanta, shkoi u ul.

- Shiko unë kam blerë diçka për ty. Samanta vendosi shtëpinë e macës afër qoshit të kaminit dhe i nxori ushqimin. Macja kur pa ushqimin e hëngri të tërën, pastaj hyri brenda te shtëpia e saj dhe e zuri gjumi. Samanta buzëqeshi. Samanta u ul dhe shikonte macën.

- Unë s'mund gjithmonë të të thëras mace, duhet të ta vë një emër. Hëëë më prit të mendoj. Mu kujtua, ty do të quaj Luna. Është emër i bukur apo jo. Pastaj Samanta kërkoi Rositen të shihte se çfar bënte, e kishte marrë malli se nuk kishte folur një kohë shumë të gjatë.

-Përshëndetje Rosita, çfar po bën, si je.?

-Përshëndetje Samanta, mirë jemi, po ti si je.?

- Mirë.

-U bë një kohë e gjatë që skemi folur, thash të shoh se ç'bën.

- Mirë bërë që telefonove.

-Xhakarta dhe Leonardo çfar bëjnë,- pyeti Samanta.

-Ato dolën të shëtisin.

-Unë nuk shkova, thash të mësoj.

-Shumë mirë, si të shkon shkolla?

-Mirë, po ti urime për bursën që kishe fituar.

-Faleminderit,- tha Samanta.

-Në regull atëherë Samanta, shihemi sepse kam disa punë.

-Po sigurisht shihemi, përshendete Xhakarten dhe Leonardon nga unë.

-Në regull faleminderit.

Pasi bisedoi Samanta me Rositen, ajo shkoi të prëgadiste diçka për të ngrënë sepse ishte bërë mbrëmje, por skishte asgjë në kuzhinë. Jasht ishte ftohtë, binte shume borë, dritat në lagjen e Samantës ishin fikur nga era e fortë. Samanta friksohej të shkoj në market. Vendosi të porosite Fast food, do të thotë ushqim i shpejtë që e sjellin deri në shtëpi. Samanta porositi dhe porosia arriti shumë shpejt. Samanta hëngri ushqim, më pas ajo shikoi një film, e duke shikuar filmin, e zuri gjumi. Samanta filloj të shihte një ëndërr të çuditshme, që ishte një mesazh për të. Çfar mendoni, çfar ëndrre vallë ishte??? Për më shumë shfletoni faqet tjera të librit. Lexim të këndshem:)

ËNDRRA, NJË MESAZH PËR SAMANTËN

Samanta filloi të ëndëroj një grua me rroba të bardha që doli para dhe i tha -Samanta unë jam Lina, duhet të të them diçka, ti para një jave kishe bërë një piktur shumë të bukur, por dje kur more ta shikosh a e mbylle shkafin? Ruaju nga armiku yt Samanta, ti ke një armike shumë të keqe.

-Kush është, të lutem më trego dua ta di.?

-Jo nuk mundem.

- Por ti bëre një vepër shumë të mirë me macën dhe kjo vepër do të shpërblej ty.

-Po ti kush je, më trego???

- Samanta!!

Ooo çfar u bë, paska qenë një ëndër , ooo ora u paska bërë 7:15

-Duhet të bëhem gati për në shkollë, do të vonohem.

Në atë kohë macja u zgjua dhe filloi të mjaulliste ishte e uritur.

- Luna tash e gjete të zgjohesh.

-Në rregull, në rregull tani do ta bëj gati ushqimin, mos dil nga shtëpia yte. Unë do ta sjell ushqimin se e ke këmben e lënduar. Luna e kuptoi se çfar i tha Samanta, qëndroi brenda në shtëpinë e saj.

Samanta ia solli ushqimin Lunës, dhe u bë gati për në shkollë. Kur shkoi në shkollë kishin orën e dizajnit, profesoresha u kishte thënë të bënë koleksionin e këti viti, por kishin edhe tre javë kohë e profesoresha i la të lirë. Samanta vendosi të shkoj te shkafi ta merte pikturën dhe ta përpunonte edhe pak, e kur shkoi te shkafi ai ishte hapur dhe piktura nuk ishte, vallë kush e mori...?

NJË DITË E HIDHUR PËR SAMATËN

Kur hapi Samanta shkafin u shtang në vend, sepse piktura nuk ishte aty. Herën e fundit kur e kishte marrë pikturën kishte haruar ta mbyll shkafin.

-Mallkuar qoftë ëndrra paska qenë e vërtet, kishte të drejtë ajo që më doli në ëndër, më paralajmeroi, por ja që mendova se është vetem një ëndër.

-Tani çfar do bëj, pas kësaj ore kemi vizatim, për sot duhet ti kemi gati, duhet të bëj diçka, por se di çfar. Në atë moment erdhi Mia.

- Samanta.... çfar ke, pse je kaq e trishtuar, trego?!.

-Mia unë dje kisha haruar ta mbyll shkafin, brenda e kam patur pikturën të përfunduar. Kur erdha sot, thash ta kontrolloj ta shoh a është aty, nuk ishte. Ne për sot e kemi t'ia tregojm profesorit.

-Çfar?... nuk ka mundësi, kush mund të ta kishte marë pikturën?

-Nuk e di.

Samanta, kemi kohë edhe tridhjetë e pesë minuta, a mund ta bësh një tjetër për këtë kohë. Jo nuk mundem, me atë kohë mund të bëhet vetëm gjysma e punës.

- Më duhet fiks një orë për ta përfunduar të tërën. A mendon se do të më qortoj profesor Xhejsoni?

-Jo Samanta, profesor Xhejsoni nuk është ashtu. Ai e do shkakun e asaj pune, dhe ti ke një shkak, ta ka marë dikush pikturën.

Kur dëshiron të kaloj koha nuk kalon, ndërsa kur nuk do, kalon shumë shpejt. Ashtu ndodhi edhe me Samantën, koha kaloi shpejt e erdhi ora e vizatimit. Profesori filloi t'i kontrolloj pikturat dhe rradha i erdhi dhe Samantës.

-Samanta ti ku e ke pikturën, orën e kaluar e kishe filluar shumë bukur ta bësh e ndërsa sot e shohë se nuk e ke pikturën?. Ku e ke më trego?

-Kanita filloi të qesh dhe tha- të gjithë e shohim se sa talente qenka. Kur një njeri nuk kujdeset për gjërat e tij, talenti i fundoset.

-Kanita mjaft nuk të pyeta ty, e pyeta Samantën,- tha profesori.

Samanta iu përgjigj shumë e mërzhitur.

-Profesor unë herën e fundit kur mora ta kontrolloj pikturën kisha

haruar ta mbyll shkafin dhe sot kur erdha ta marr piktura nuk ishte.

-Pretendon që ta ka marrë dikushi?

-Mendoj se po.

-Si mund të thuash ashtu, dmth se të ka humbur ty piktura, patjetër duhet të ta kish marr dikush,- tha Kanita.

-Kanita, Samanta nuk të tha se ti ia ke marrë, tha mund ta kish marrë dikushi, nuk e di pse e more mbi vete, mos vallë me të vërtet ti e ke marrë?.

-Kanita u zbeh, -sig...urisht sigurisht që jo, ç'më duhet piktura e shpifur e saj.

-Mjaft më me këtë sjelle injorante,- tha Profesori.

Kanita s'tha më as gjë.

-Në rregull, Samanta mos u brengos, mund të fillosh prej fillimit,- tha Profesori.

-Por ne të gjithë e kishim për sot dorëzimin e pikturës, dhe nese nuk i kishim me vete pikturën, na the që do na përjashtoj,-tha Kanita.

-Mjaft më, më duket se ty do të përjashtoj –tha Profesori.

Mbaroi ora e ligjeratës, të gjithë dolën në pushim.

-Samanta a mendon se mund të ta kish marr dikush pikturën,-tha Mia.

-Po,- iu përgjigj.

-Kush mendon se mund të jetë?.

-Unë mendoj se është Kanita, e pe si reagonte kur profesori fliste, por mos i thuaj gjë askujt , të lutem.

-Në rregull, mos u brengos.

- E di që edhe njëhere më ka ndodhur kështu kur isha në Amerikë. Shoqja ime e klasës, Ana, ma kishte marrë vizatimin, e thoshte kinse ajo e kishte vizatuar. Por pastaj ajo e kuptoi gabimin dhe më kërkoi falje.

-Interesant,-tha Mia .

-Po Mia, ia ktheu Samanta. Samanta dhe Mia po ecnin gjat rrugës kishin blerë lëngjë dhe kur i pëfunduan lëngjet shkuan ti hedhin tek shporta e mbeturinave, kanaqet. Dhe a e dini se çfar panë aty?!! Në vazhdim do të shihni se kush e kishte marrë pikturën, dhe ku e gjetën.

PIKTURA U GJET E SHKATRUAR

Samanta së bashku me Mien shkuan të hedhin kanaqet në koshin e plehrave, atje e gjeti pikturën të hedhur. Piktura ishte dëmtuar krejtësisht dhe pas saj shkruante: -“KUJDES ME VEPRIMET E TUA NDAJ MEJE, SEPSE TË GJITHA VEPRAT E TUA DO I GJESH KËTU”, - NGA SHKATRUESJA E VEPRAVE TË TUA.

-Nuk mund ta besoj kush e ka bërë këtë gjë?

-Prit Samanta, mos u mërzit do ta gjejmë një zgjidhje. Mu kujtua dicka,- tha Mia. Fotoografoje pikturën, dhe mesazhin e shkruar në të pas saj.

-Mirë thuash do e fotografoj dhe do ia tregoj Profesor Xhejsont.

-Faleminderit Mia.

-Të lutem s'është gjë.

Pasi e fotografuan pikturën dhe mesazhin në të, Samanta vendosi që orën tjetër t'ia tregonte Profesorit atë që kishte parë. Koha kaloi shumë shpejt, erdhi ora e vizatimit por këtë rradhë Samanta e kishte rikrijuar një vizatim tjetër, e kishte në dorë argumentin për dëmtimin e pikturës së parë.

- Samanta po shoh që sot e ke vizatimin!

Po profesor unë e bëra pikturën nga fillimi, ndërsa pikturën që kisha përpara e gjeta në koshin e mebeturinave.

-Cili ose cila, mendon se e ka bërë këtë? .

-Mia u përgjigj në vend të Samantës,

-Mendojmë se Kanita e ka bërë.

-Çfarë..... jo unë, se kam bërë,- tha Kanita.

-Atëherë pse bën panik, kur thua më që se ke bërë ti,-U përgjigj Samanta e nervozuar, të paktën qëndroj pas asaj që e bëre.

-Jo, vetëm të njollosem për një gjë që se kam bërë nuk është e drejt.

- Ashtu a, po ja atëherë, ja shikoje a është shkrimi yt, ky që ishte shkruar mbrapa pikturës? tha Samanta.

-Jo ky nuk është shkrimi i im, pse po më fajsoni për një gjë jo konkrete

-Kjo është konkrete,- tha Samanta. Ne e kemi parë, ja shikoje e kemi fotografuar.

- Çfar, ju gënjeni, dy varfanjake...

-Shiko këtu do të mbys unë ty....ju kthye Samanta....

-Mjaft më,- tha Profesor Xhejsoni. Mendoj ta bëjmë kështu, të gjithë shkruani në letër, e do e shohim se kujt i ngjan ky shkrim.

Të gjithë pranuan vetëm Kanita thoshte,-Jo unë nuk bëj kur far shkrimi, se kam bërë unë.

- Mjaft Kanita, unë thash të gjithë, dhe fillo bëje një shkrim.

Të gjithë i bënë shkrimet dhe ia dorëzuan profesorit, ndërsa Kanita e friksuar ia dha e fundit shkrimin.

-Eja Samanta, shiko cili shkrim i ngjason atij të pikturës?.

Samanta i kontrolloi të gjitha shkrimet, e kur ariti te shkrimi i Kanitës, shikoi me kujdes shkrimin dhe tha,- Profesor ky është shkrimi i njejtë me atë të Kanitës.

-Jo gënjen profesor... Profesori ia ndërpreu fjalën.

Nëse nuk është i yi ky shkrim, atehër pse bëre panik kur ua kërkova shkrimet të gjithëve. Diskutimi mbyllet këtu, kërkoi falje Samantës, dhe pastaj eja me mua në Drejtori.

-Por...

-Mjaft thash, kërkoi falje Samantës.

Kanita mezi e nxori fjalën nga goja dhe i tha,- Më fal edhe pse se kam bërë unë.

-Ashtu qoftë edhe një herë të mos kesh punë me mua dhe gjërat e mia, për ndryshe...

-Mia ia nderpreu, dhe tha keq e pëson.

-Mjaft mos u grindni, eja në Drejtori, - tha profesori.

-Nuk e di se çfar ke me Samanten, ti ke bërë një veprim fëmijëror.

-Më ngjasoni fëmijë pesë vjeç, me vjen turp s'di çfar t'i them Ddrejtorit, se nxënësja e shkollës tonë ka vjedhur një pikturë shoqes së klasës.

- Do me vëni në pozitë të vështirë. E ti Kanita, do të përjashtojnë nga shkolla s'di çfar të them.

-Profesor, nëse do e lemë me kaq, mos e dërgo në Drejtori, nuk dua që të bëhem shkak e një studente të re të ngeli pa shkollë, ndoshta e ka kuptuar gabimin,- tha Samanta .

-Edhe nëse se ka kuptuar, e mësojmë ne,-tha Mia.

-A dëgjoje Kanita tani Samanta të fali një shans ty, dhe duhet ta

vlersosh,- tha Prfessori.

-Po Profesor, e falemenderoj Samantën që ma dha shansën,-tha Kanita dhe e shikoi me nervozë Samantën.

-Në rregull e mbyllim këtë temë tani do bjerë zilja. E humbëm orën për shkak Kanitës.

-Orën tjetër fillojmë me punimin që kishim sot.

-Më fal Profesor nuk do përsëritet më.

- Në rregull, shihemi orën tjetër,mirupafshim.

-Diten e mirë.

-Të gjithë filluan të dalin për pushim, ndërsa Kanita i tha Samantes,- Prit ndalo kemi diçka për të biseduar.

Kanita ishte me dy shoqe tjera, ndërsa Samanta ishte vetëm me Miën.

- Unë e thira vetëm Samantën, jo ty.

- Ashtu, e po le të largohen edhe këto dy shoqet e tua, atëher largohem edhe unë.

-Në rregull qëndro këtu ,-tha Kanita.

-Po ti nuk të pyeta a të qëndroj apo jo, thash thjesht këtu do ri me shoqen time.

-Në rregull mos u grindni. Kanita urdhëro se s'kemi kohë shumë, çfar ke?

-Unë doja të thoja që mos u ngatro me mua, se e ke veshtirë. Herën e parë shpëtove lehtë, por herën tjetër, veten do e gjesh para derës së shkollës.

- Ashtu mendon, mirë mund ta gjesh ti veten para derës së shkollës, vetëm me dy fjalët e mia, e humb shansën që ta dhash,- tha Samanta kështu që mendohu mirë para se të flasësh përsëri vazhdoi ajo.

-Ti po më kërcnon mua?.- tha Kanita.

-Jo vetëm të paralajmërova.

- Dëgjom Kanita, më detyrove të flas në gjuhën që ti kupton. Më zbritte në nivelin tënd, po nuk jam njeri i tillë. Unë të thash të më lësh rehat, dhe mos u përzi në punet e mia.

-Ashtu, as ti mos u përzi në punët e mia.

-Në rregull, e mbyllim me kaq.

-Ne shkojmë, kemi punë më të rëndësishme se ju, shihemi se shpejti ,-i tha Mia.

-Samanta me Mien shkuan, ndërsa Kanita,- u tha shoqeve, para se të më nxjer ajo nga shkolla mua, unë duhet ta nxjer atë dhe t'ia japim një mësim asaj Miës që flet shumë për këtë gjë, do me ndihmoni ju.
- Mos u brengos, ne do e kryejm këtë punë si është më së miri,- thanë dy shoqet e Kanitës.

Pas mësimit shkuan të gjithë në shtëpi. Ndonjë herë dhe njeriu i mirë gabon, dhe flet fjalë që s'duhet thënë. Kështu Samanta veproi me Kanitën, nervoza dhe hakmarja të bëjnë krejtësisht tjetër njeri.

PËRJASHTIMI I SAMANTËS DHE MIËS NGA SHKOLLA

Një ditë e bukur, dimri filloi të shkoj, erdhi pranvera. Akullnajat filluan të shkrihen, borës i kishte ra një diell i ngrohtë dhe ajo po shkrihej. Pikërisht Samanta atë ditë shkante në shkollë, por friksohej mos i ndodh ndonjë gjë macës Luna, të cilën e kishte lënë në shtëpi dhe i kishte vënë vetëm qumësht. Ajo ngutej për shkollë, por mendjen e kishte tek macja. Atë ditë, orën e dytë kishin dizajn. Kishte kaluar një muaj që profesoresha u kishte thënë të bënin koleksionin e këti viti. Pikërisht kjo ditë, për Samantën, do ishte një ditë tepër e keqe. Kanita me shoqet e saja i kishin bërë kurth Samantës. Ora e parë kaloi shpejt.

-Samanta do vish për pushim të dalim pak të marim ajër të pastër,- i tha Mia.

- Po tani, erdha.

-Vetëm mbylle shkafin, sepse aty i ke dizajnet, mos të ti vjedhin përsëri, si atëher.

-E kemi mësuar gabimin,- tha Kanita.

-Mirë që e paskeni mësuar, mos vinte puna që të ta mësonim ne,- tha Mia dhe qeshi.

-Qesh, qesh të shohim se kush do qesh i fundit,-tha Kanita dhe e shikoi Samantën duke qeshur.

Pasi dolën Samanta dhe Mia nga klasa, Kanita dhe dy shoqet e saja filluan ta bënin kurthin që kishin para planifikuar. Kishin menduar që në çantën e Samantës ta fusnin koleksionin e Kanitës, e pastaj t'i thonin profesoreshës kinse Samantai ka vjedhur koleksionin Kanitës. Pastaj ta akuzonin për vjedhje, e ta përjashtonin nga shkolla. Ky ishte mendimi i Kanitës.

Ra zilja për të hyrë në klasë. Kur hyri profesoresha, Kanita e panikuar tha-Profesoreshë Xhesika, nuk e kam koleksionin, pak më parë këtu në çantë e pata, e pastaj dola jashta se ishte pushim.

-Kush ishte e fundit në klasë, Kanita?

-Samanta dhe Mia ishin të fundit.

Por vajzat, pra shoqet e Kanitës çfar kishin bërë, e dini? I kishin futur gjysmat e dizainit në çantën e Samantës, dhe gjysmat në çantën e

Miës, që për një ditë t'i përjashtojn të dyjat nga shkolla.

-Ashtu, atëher nxjerni çantat, ju dyjat.

-Në rregull thanë të Samanta e Mia, ishin shumë të qeta, e kur i nxorën gjërat që kishin në çanta, u habitën kur i panë dizajnet e Kanitës.

-Kanita a janë këto dizajnet tua, - pyeti profesoresha.

-Oh, po profesoreshë.

-Ju të dyja a nuk keni turp, -u tha Profesoresha. Si mund t'ia bëni shoqës këtë gjë.

- Profesoreshë ne asgjë si kemi marr "Shoqes sonë". Ajo vetë e ka planifikuar këtë gjë. Nuk ishim ne të fundit në klasë, por ato.

-A nuk ishe ti Kanita, ajo që ia vodhe Samantës pikturën e ia hodhe në mbeturina, plus edhe e kërcnove atë, apo jo, trego?!

-Në rregull lere Mia.

-Samanta dhe Mia ejani te Drejtori. Jeni të akuzuara për vjedhje, duhet të iu përjashtojmë nga shkolla.

- Prit, prit kërkoni falje Kanites,-tha profesoreshë Xhesika.

-Unë do vdes, por kur si kërkoj falje, e s'kam bërë as gjë që t'i kërktoj falje asaj, -tha Mia.

-Mjaft, kërktoj falje Kanitës.

-Samanta nuk tha asgjë, i kërkoi falje, e shikoi drejt në sy dhe pastaj tha,- Çdo kush do e merr atë që e meriton.

Ndërsa Mia plasi derën dhe doli nga klasa. Pastaj shkuan në drejtori. Profesoreshë Xhesika i tregoi gjithçka Drejtorit. Drejtori, Miës dhe Samantës u tha;- Edhe sot deri në fund të orëve mund të qëndroni dhe ditët tjera të mos u shoh këtu, jeni të përjashtuara.

-Por drejtor ne...

-Mjaft shkoni në klasë dhe prej nesër mos t'iu shoh këtu.

-Në rregull, por ta dish Drejtor që do e dëshmojmë se jemi të pafajshme dhe nuk mund dënuar njeriu pa e dëgjuar,-tha Samanta.

-Dilni shpejt që këtu- tha Drejtori.

Samanta ishte e nervozuar aq shumë sa që filloi të qajë.

-Samanta çfar ke, mos qaj, nuk ia vlen për ato të poshtra.

-Jo nuk qajë për ate, po qaj për fatin tim të keq e humba edhe këtë shans që pata. Qajë nga se jam lodhur, përballova shumë gjëra e nuk mund të vazhdoj më kështu.

-Jo mos u dorëzo më ke mua, unë jam shoqja jote, përballoje edhe këtë të lutem.

-Nuk mund Kanita, të jetë me fortë se ti. A thoshe ti gjithmonë duhet të luftosh për të vërteten, dhe tani është çasti.

- Samanta fshiu lotët dhe tha, - Ke të drejtë, duhet ta përballoj edhe këtë. Duhet ti japim një mësim shumë shumë të forët Kanitës që të pendohet për këtë që e bëri.

-A ti japim nje dajak, si thua,- tha Mia.

-Sigurisht që jo, e ke seriozisht ?.

- Jo po tallem për të qeshur ti.

-Faleminderit Mia, mirë që të takova ty në këtë vend. Vetëm ti më ke përkrahur dhe më ke mbështetur kur kam pasur vështirsi.

-Mos fol kështu edhe ti je e njejtë për mua. Ajo është detyrë e gjitha shoqeve.

-Ke të drejtë, tani eja në klasë për herë të fundit.

-Po në fakt, jo për herë të fundit.

Të dyja shkuan në klasë, ora kishte mbaruar dhe ishte pushim. Të gjithë dolën vetëm Kanita mbeti e fundit.

-Kanita prit këtu. Ti a je e çmendur apo të ka marë malli të vizitosh spitalet,e di që të gjitha ti i planifikove, për të na larguar nga shkolla, por dije që kjo histori nuk mbaron këtu,- thaSamanta.

-Po e gjithë ishte ideja ime, nuk iu doja juve në këtë shkollë, dhe ia arita qëllimit.

-Po pse nuk pranove para Profesoreshës, që ti e berë këtë edhe pse ne skemi faj?. Do përjashtohemi nga shkolla, e gjithë kjo është dredhia jote.Ndërsa Samanta dhe Mia kishin berë një plan, e dini se çka?.Samanta kur ka biseduar me Kanten, Mia i ka incizuar për tia treguar Drejtorit. Pasi bisedoi Samanta dhe Kanita,

-Mia tha, plani u krye tani kemi dëshmi në dorë.

Më pas shkuan në shtëpi. Të nesërmen kur shkuan në shkollë, e dini se çfar ndodhi? Në vazhdim do e shihni se çfar ndodhi me Samantën dhe Miën. Do të jetë një kohë shumë e vështirë për to.

PLANI NUK FUNKSIONOI

Të nesërmen kur Mia dhe Samanta shkuan në shkollë u ndodhi një gjë e keqe. Ato mendonin se plani do iu funksiononte por nuk ndodhi kështu. Kanita e kishte ditur se çfar plan ishin duke bërë Mia dhe Samanta, kështu që para se të shkonin ato dyja në drejtori, Kanita e para kishte shkuar te Drejtori dhe i kishte thënë,-Mirdita Drejtor, më fal nëse të pengoj, por desha të të them diçka për rastin e djeshëm.

-Mendoj që ato të dyjat mund të bëjnë montazh me zërin tim, kinse unë ua kam futur dizajnet e mia, në çantat e tyre domethën të pranoj diçka që se kam bërë.

-Mos u brengos, unë e kam ditur që do të veproinin ashtu, -tha Drejtori.

Në atë moment në zyrë të drejtorit hyri edhe Mia edhe Samanta.

-Mirdita Drejtor, erdhëm fiks në kohë,-tha Samanta.

-Ne e inçizuar Kanitën, ajo e pranoi, që kishte planifikuar gjithçka.

-Ja shikoe videon. Kanita që ndjehej e sigurt, filloj të qesh. Drejtori pasi e ndoqi videon, tha;- Ju prisni që une ti besoj kësaj montazhe.

-Jo Drejtor ne.....

-Mjaft sot është hera e fundit që vini këtu, mos t'iu shohë më në këtë shkollë.

- Në rregull Drejtor, ditën e mirë. Ndërsa ti Kanita, mos mendo se na hoqe qafe, loja tash sapo ka filluar,- tha Mia.

-Shiko Drejtor, po më kërcnojnë.

- Çfar është kjo sjellje, më shpejt jasht, mos t'iu shoh këtu.

-Më mirë një sjellje e keqe se sa një e çmendur në shkollë drejtor... por kjo nuk do të jetë hera e fundit që do të takohemi. Ditën e mirë, do shihemi përsëri Kanita.

Pasi dolën nga drejtoria, Samanta tha,- Me siguri ajo i ka thënë drejtorit që ne kinse kemi bërë montazh. Por nga e kuptoi që ne e inçizuar, -tha Mia.

-Me siguri ka qenë ndonjë shoqe e saj afër nesh, kur ne kemi biseduar. Tani nuk është kjo me rëndesi Mia.

-Ne mbetëm pa shkollë, çfar do bëjmë tani?. Unë humba shansën e ëndrrës sime, tani zonja Miranda nuk do më pranoj të punojë në

firmën e saj për dizajn.

-Mos fol kështu, a the ti që ajo është një grua e kuptuar. Nëse i tregon se çfar ndodhi, ajo do të kuptoj, dhe me siguri do të pranoj në punë.

-Me të vërtet mendon kështu?. Po sigurisht, eja tani të shkojmë skemi punë në këtë shkollë.

-Në rregull, eja të shkojmë.

Të dy shoqet shkuan në shtëpitë e veta, me shpresë se do ktheheshin përsëri në shkollë. E po kështu miq të dashur ndonjë herë xhelozia të verbon krejt, dhe nuk di se ç'bën. Ashtu ishte me Kaniten e cila ishte e mbushur me mllef. Ndërsa Samanta dhe Mia ishin ato që pësuan në këtë rast. Njeriu mund të xhelozoj, por kur të xhelozoj të thotë "Unë mund ta bëj çdo pune më mirë se ajo, por me punë, jo me armiqësi". Xhelozia ndonjë herë është e mirë sepse edhe unë kam xhelozuar dhe kam thënë, që edhe unë mund të bëj diçka me punë, jo me urejtje dhe hakmarje. Edhe ju nëse xhelozoni dikë, thuani vetes se mund edhe ti ta bësh atë gjë, por mos haro gjithmonë me punë, e jo me hakmarje mllef dhe urjejtje.

KOHA S`KALON, KUR TI DËSHIRON

Ditët s'kalonin, koha ndalonte kur njeriu ishte i mërzhitur, kjo i ndodhi edhe Samantës. Një minut për të zgjaste sa një orë, por ajo gjithsesi ishte e lumtur që kishte macen e saj, e cila çdo dite e gëzonte. Macja, e cila gjithmonë se kishte lënë në vetmi, ajo ishte macja Luna. Gjithsesi dimri kaloi, po vinte pranvera e bukur, dielli shkëlqente sikur më parë, natyra përsëri kishte marrë ngjyrën e gjelbërt. Samanta e cila kishte mbetur në mes të rrugës, dua të them, kishte mbetur pa shkollë pa e realizuar ëndrrën e saj. Ditët për Samantën kalonin nga dalë. Një ditë vendosi të shkoj te zonja Miranda, që ta falemenderonte për shansën që ia kishte dhënë. Dhe ashtu bëri, madje mori edhe macën Luna që ta shëtiste pak jashtë. Kur ariti te firma DESIGN COLLECTION, kishe frigë se a do i besonte zonja Miranda për historin në lidhje me shkollën. Samanta hyri brenda e shkoi te zyra e znj. Miranda. Kur hyri në zyrë, aty ishte zonja Miranda. Këtë rradhë nuk ishte si herën e kaluar, ishte pak sa e sëmurë.

-Përshëndetje zonja Miranda, si jeni?

-Oh, përshëndetje Samanta, unë jam mirë, ti si je ?

- Mirë të themi.

-Si ia çon me shkollën, a të pelqeu vendi, pra shkolla, a kishe shoqëri, a je ambijentuar?

-Oh zonja Miranda, pikërisht për këtë kam ardhur.

-Pse çfar ndodhi Samanta,-e pyeti zonja Miranda.

Samanta ia tregoi të gjithë historin, për Mien, Kanitën dhe Drejtorin.

- Nuk e di a e besuat këtë që thash, por më besoni se gjithçka që thash është e vërtetë.

-Nuk e di ç'të them Samanta. U shokova, normalisht që të besova ty, ti je një vajzë shumë e mirë dhe nuk besoj se dëshiron t'i bësh keq dikujt.

-Faleminderit që mendoni kështu për mua, Zonjë dhe ju jeni e njejtë.

- Samanta, nuk di se çfar mund të bëj, nëse të duhet ndihma ime ja ku e ke numrin tim të telefonit, lajmëro kur të duash.

-Faleminderit Zonjë.

-Samanta dua të të bëj një pyetje.

-Po sigurisht, urdhëroni.

-Nëse do të ftonin përsëri të shkosh në atë shkollë, a do pranoje?

-Nuk e di Zonjë, mendoj që jo, sepse nga ajo derë që më dëbuan nuk mund të hy përsëri. Ato më nxorën nga shkolla. Sikur të del edhe e vërteta në shesh, nuk do pranoja të shkoja përsëri në atë shkollë.

-Të kuptoj, por ti edhe pse nuk e kryer fakultetin, ke një talent të veçant dhe jo të gjithë e posedojnë një talent të tillë.

-Faleminderit Zonjë që vlersoni atë që unë di të bëj më së miri.

-Nejse të mos të marr me shumë kohë, vetëm desha të të falemenderoj për mundësinë që më dhatë.

-Çfarë është kjo fjalë, je e mirseardhur kur të duash.

- Faleminderit, shpresoj të shihemi përsëri.

-Shihemi Samanta.

Pasi Samanta doli nga firma bashkë me macën shkuan në market për të blerë diçka. Pastaj shkuan në shtëpi.

Dhe Samanta tha,- Si spo kalon kjo kohë e macja mjaulliu. Kështu më në fund mbaroi kjo ditë. Macja Luna dhe Samanta kishin rënë në gjum shumë shumë të thellë.

PIKTORËT E FSHATIT

Erdhi pranvera, i gjithë fshati gëzohej për ardhjen e saj, por më së shumti gëzohej Samanta dhe Luna. E dini pse u gëzua Samanta dhe Luna? Sepse Luna dimrit nuk ka mundur të shëtiste jashta e ndërsa Samanta.... Do iu rëfej me vonë.

Lulet shumë ngjyrshë kishin mbulluar kopshte e parqe, kishin gjithandej natyrën këtë natyrë të gjelbërt.

Milano shkëlqente përsëri, gjithashtu edhe fshatrat që e rrethonin bashkë me pranverën. Pranvera solli edhe një surprizë për Samanten. Samanta tani nuk ishte në shkollë por dëshironte të punonte diçka, dhe gjithmonë thoshte,- Nuk mund ta harxhoj kohën kot. Një ditë vendosën të takoheshin me Mien. Ato bisedonin se çfar do bënin, çfar do punonin tani.

-Të gjitha ëndrrat na prishi Kanita, të cilën e kishte mbuluar xhelozia, e cila për ne shpifi kot, tani edhe ne do ishim duke mësuar si nxënësit tjerë.

-E po ç'të bëjmë, ky është fati ynë. Kam një ide tha,- Mia. Pse ne nuk pikturojmë këtu në qendër të fshatit e pikturat ti nxjerim në shitje dhe pastaj me ato para që fitojmë ta hapim një kurs për vizatim, Si thua?

-Është një ide e mrekullueshme. Me të vërtetë flet pak si shumë, por ke ide fantastike.

-Atëher ç'presim Samanta, të fillojmë me punë.

Te dyja ia filluan punës. Ishin duke kërkuar një vend të përshtatshëm ku do mund të pikturonin. Gjetën një vend ku të gjithë mund t'i shihnin e ku mund të inspiroheshin për të pikturuar.

-Ky është vendi i duhur për të pikturuar, është një vend ku të gjithë mund ti shihnin dhe mund të vinin e të blejnë piktura.

-Po ashtu është,- tha Mia.

Ato të nesërmen shkuan dhe e rregulluan vendin ku do të pikturonin. Afër qendrës vendosen dy tavolina për t'i vendosur pikturat dhe dy karike, për Samanten dhe Mien, ku do mund të pikturonin.

Ato shkuan herët, ia filluan punës, kishin bërë katërmbëdhjetë piktura për një ditë. Edhe pse ishte dita e parë e punës, pikturimi shkoi shumë mirë, njerëzit filluan të blejnë me një herë. E dini se çfar

bënin, tani Samanta dhe Mia?, Bënin portrete të njerëzve, të cilët i paguin shumë mirë. Ishin bërë dy javë që kishin filluar me punë, dhe shihej një ndryshim i madh te këto. Fshatarët e dini si filluan ti quanin ato? Piktoret e fshatit. Ato ndjeheshin krenare me punën që bënin, sepse bënin atë që dëshironin. Edhe njerëzit mund ta shihnin talentin e tyre. Pra, lumturia për to gjendej në punë, aq sa më shumë punonin, aq më të lumtura ndjeheshin, sepse i gëzonin edhe njerëzit me punën e tyre, ndërsa Luna e dini çfar bënte?. Ajo shkonte luante me macet tjera. Ndonjëher vinte tek Samanta e Mia, e i shikonte si pikturonin. Kështu Mia dhe Samanta ndjeheshin të lumtura se ia aritën qëllimit që dëshironin, vetëm edhe kishte mbetur ta realizonin ëndrrën e tyre.

Miq të mi, kam një këshill për ju,-Ndiqeni ëndërrat tuaja, bëni atë që dëshironi, besoni se do jeni shumë të lumtur me atë që do e bëni dhe gjithmonë dëgjoni zemrën tuaj .

Në vazhdim do shihni surprizat që solli pranvera për dy shoqet.

ZONJA MIRANDA ERDHI PËR VIZITË

Një ditë e bukur pranvere, i gjithë fshati ishin zgjuar për punë., Gjithashtu edhe Samanta me Mien u ndodhi një gjë jashtëzakonisht shumë e bukur. Ju thash që pranvera për to do sillte shumë surpriza. Atë ditë, si gjithmonë Samanta dhe Mia, u takuan në qendër të fshatit.

-Mirmëngjes Mia, si je?

-Mirmëngjes Samanta, mirë jam ti si kalove me këtë Macë lazdrake, dhe e përkedheli Lunën?

-Samanta qeshi dhe tha;- Mirë, si të kaloj, Luna gjithmonë është ashtu e lëvizshme.

Macja sikur i kuptoi dhe mjaulliu.

-Në rregull t'ia fillojmë me punë sa nuk kanë ardhur njerzit për të blerë piktuar,- tha Samanta.

- Po sigurisht, po sot ç'do bëjmë piktura apo portrete?

-Të shohim kërkesat e njerëzve, mendoj se më shumë piktura po shitet.

- Duhet të bëjmë piktura për pranverën e bukur.

-Po sigurisht por unë s'kam asnjë ide,- tha Mia.

-Le të shohim, heëëm..... mu kujtua diçka,- tha Samanta.

-Çfarë na trego? Pse nuk e vizaton këtë që sheh, pra përshkrim të natyrës.

- O po është ide shumë e mirë, do e vizatoj fshatin dhe lulet, njerëzit dhe Lunën e vogël apo jo?

-Po do të jetë një piktur jashtë zakonisht e bukur.

-Po ti Samanta çfarë do bësh?

-Vetë e the, -tha Samanta.

-Jo unë nuk thash asgjë,- tha Mia.

-Doja të e them,- Do e vizatoj një lule Orkide.

- Oh, po është ide fantastike ,-tha Mia.

-Më duket se mi vodhe idetë ti, kohë më parë shumë ide të mira kisha, e tani skam asnjë, u tall Mia dhe qeshi.

-Epo ç'të bëjmë,-tha Samanta dhe qeshi.

Duke biseduar, ato gjithashtu kishin bërë edhe gjysmën e punës.

Dalë nga dalë filluan të vinin edhe njerëz për të blerë krijimet. U pëlqenin shumë pikturat e Miës dhe Samantës. Ndër kohë Mia kishte bërë tre piktura me përshkrim të natyrës. Ndërsa Samanta, edhe ajo kishte bërë tre piktura në lidhje me lulet dhe ishte duke e përfunduar edhe pikturën e katërt. E dini cili ishte blerësi i parë këtë ditë? Ishte Miranda.

- Përshëndetje Samanta dhe Mia.

-Oh, Zonja Miranda, na gëzove shumë, përshëndetje, eja ulu këtu.

-Dëgjova se kishit filluar të pikturoni,- tha Miranda.

-Po zonjë,- tha Mia.

-Prit ti shoh se çfarë piktura keni bërë?

-O po këto piktura qenkan të jashzakonshme janë shumë të bukura.

-Faleminderit zonjë,- thanë Samanta dhe Mia.

-Zonjë më lejoni që këtë piktur t'ua dhuroj juve,- tha Samanta, të keni një kujtim nga unë.

-O po kjo qenka shumë e bukur, qenka një orkide. Po Zonjë, kjo ishte piktura e parë që bëra sot.

-Faleminderit Samanta, kjo është dhurata e parë që mora për ditëlindje. Me të vërtetë sot e ke ditëlindjen? Po, iu pergjigj zonja Miranda.

-Atëherë urime ditëlindjen zonja Miranda.

-Faleminderit shumë.

-Me qenë se sot e ke ditëlindjen, më lejoni që këtë portret që e bëra, t'ua dhuroj juve,- tha Mia.

-Oh faleminderit, je shumë e mirë,-tha Miranda.

Meqenë se zonja Miranda kishte ditëlindjen ato mbaruan herët me punë. Samanta i ftoj edhe Mien dhe zonjën Miranda në shtëpinë e sajë. Me qenëse ishte pranverë, ato vendosen ta hanin darkë në terasë, ku mund të shihnin njerëzit dhe natyrën e bukur. Ndër kohë Mia dhe Samanta përgaditnin diçka në kuzhinë, dhe të dyja bashkë i kishin blerë një tortë dhe dhe bluzë të hollë, zonjës Miranda.

-Si thua a do të gëzohet kur ta sheh dhuratën,- tha Mia.

-Mendoj se po, do gëzohet shumë. Pasi bënë gjithçka gati, hëngrën darkën dhe pastaj ia treguan tortën Mirandës.

-Urime ditëlindjen zonjë, kjo është dhuratë nga ne të dyja.

-O faleminderit shumë, kjo është ditëlindja më e bukur që kam pasur

ndonjë herë, dhe mos më thërisni zonjë, po teta Miranda.

-Në rregull teta Miranda,- tha Mia.

-Ja edhe kjo është një dhuratë nga ne dyja, shpresoj të të pelqej .
Miranda hapi dhuratën dhe tha;- Është shumë e bukur, më pëlqeu shumë, jeni më të mira.

-Nuk ka gjë,- thanë të dyjat, dhe festuan bashkë të lumtura sikur më parë. Ndërsa Luna, atë e zuri gjumi, sepse ishte një macë shumë e lëvizshme, dhe flinte herët.

NJË SËMUNDJE E PAPRITUR E LUNËS

Të nesërmen zonja Miranda u largua. Samanta dhe Mia ishin të lumtura që kaluan një ditë me Mirandën. Të nesërmen Luna ishte sëmur. Në mëngjes kur u zgjua Samanta, pa Lunën të sëmurë. Ajo mendoj që ishte e uritur, por jo.

-O Luna, çfar ke, pse nuk han asgjë.

Këtë rradhë Luna as nuk mjaulliu. Samanta u frikësua shumë, dhe vendosi ta çoj në veterinar. Në atë moment i telefonoi Mia .

-Përshëndetje Samanta, unë jam në qendër të fshatit, ti ku je?

-O mos pyet Mia, Luna është e sëmur, nuk han asgjë, madje as nuk mjaullin. A mundet Mia, unë sot të mos vij sepse do e çoj në veterinar Lunën,-tha Samanta.

-O po sigurisht mund të shkosh.

-Faleminderit shumë Mia, por si duket sot do bie shi, qenka koha e vrejtur.

-Si do punosh, edhe qendra nuk është e mbuluar?

-Mirë thua, atëher sot nuk punojmë, do shkojmë të dyjat ta çojmë në veterinar Lunën.

-Nëse dëshiron edhe unë të vi me ty.

-Po sigurisht do më ndihmosh pak të flas Italisht se nuk di shumë mirë!

-Po sigurisht.

-Atëherë takohemi te veterinari i qytetit. Në rregull shihemi atje.

Ashtu bënë Mia e Samanta, u takuan te veterinari pastaj hyrën brenda në ordinancë. Mia filloi të flet me veterinarin, i tregoi se çfar kishte macja e vogël.

-Ma jepni ta kontrolloj.

Veterinari kontrolloi macen, dhe tha,- Është një virus te të gjithë kafshët, i është ngjitur edhe maces suaj.

- A është shoqëruar me ndonjë kafshë tjetër,- Po, tha Samanta.

Atëher iu sugjeroj t'ia bleni këtë gjë, është një lloj medikamenti për macet e sëmura dhe më besoni nëse e pi këtë do shërohet shumë shpejt.

-O ju faleminderit,- tha Samanta në Italisht.

-Ska gjë, kjo është puna ime.

-Ditën e mirë.

-Gjithashtu edhe juve paçi ditë të mirë.

Pasi dolën nga veterinari, Samanta me Miën shkuan ta blenin atë medikament që tha veterinari.

-E shikon Luna, nëse e pin këtë ilaç do shërohesh shpejt, ti je e vogël do të kaloj shpejt. Pasi e morën atë që tha veterinari, Mia u përshëndet me Samanten e shkoi në shtëpinë e sajë. Ndërsa Samanta me Lunën edhe ato shkuan në shtëpi. Samanta i dha ta pijë atë që e kishte blerë në barnatore, Lunës. Macën e zuri gjumi, ndërsa Samanta mori ta vizatoj macën e saj të dashur. Pasi e vizatoi macën filloi të bëj edhe disa piktura tjera që t'i kishte gati për nesër. Duke pikturuar e kishte zënë gjumi, epo ishte një ditë e lodhur për Samantën dhe macën e saj që shpresojmë të shërohet.

LEONARDO, XHAKARTA DHE ROSITA NË VIZITË TE SAMANTA

Edhe kjo ditë, si të gjithë ditët tjera filloi bukur, vetëm se tani macja e vogël ishte shëruar.

-Mirmëngjesi Luna, ja ku e ke ushqimin.

-Unë jam vonuar duhet të shkoj. Macja iu vu pas Samantes dhe mjaulliu.

-Jo do qëndrosh këtu sepse përsëri do sëmuresh. Macja vazhdoi të mjaulli përsëri. Ohh, në rregull, eja por do të qëndrosh aty me mua, nuk do shkosh tek macet tjera. Samanta mori Lunën dhe doli nga shtëpia. Kur aritën në qendër të qytetit aty ishte Mia duke i pritur.

-Mirmëngjesi Mia.

- Mirmëngjesi Samanta, o Luna edhe ti ke ardhur, por të lutem mos shko tek ato mace sepse do sëmuresh përsëri. Macja sikur e kuptoi dhe iu hodh në krah Miës.

-Sa e mirë që je, moj Luna. Në rregull tani, ti qëndro këtu, sepse ne tani kemi punë.

- Mia unë mbrëmë bëra disa piktura, ja këto.

-Qenkan shumë të bukura, prit te kjo pikturë a është Luna duke fjetur?

-Po, është shumë e bukur, këtë do e shesim me çmim me të lartë.

-Po sigurisht,- tha Samanta.

Ndër kohë blerësit filluan të vijnë. Kishin mbetur vetëm dy piktura pa mos u shitur. Por të dyjat nuk ndaleshin së punuari, ndërsa Luna vetëm i shikonte.

-Kjo ditë ka pasur shumë piktura të shitura është dita jonë me fat,- tha Mia.

- Po ashtu është.

Samanta dhe Mia kishin bërë një blerës të rregullt, gjithashtu e kishin bërë si shoqe, ajo quhej Marina.

-Përsëndetje vajza, çfar bëni, si ja kaloni?.

-Përsëndetje Marina, jemi duke kaluar shumë mirë, ti si ia kalon?

-Mirë faleminderit.Unë erdha këtu për të më bërë një portret të

motrës sime, sepse ajo nesër e ka ditëlindjen, a do mund të ma përfundoni deri nesër në mëngjes?!

-Po sigurisht,- tha Mia.

-Në rregull vajza, një portret dhe një natyrë të qetë pranvere.

-Në rregull vetëm se duhet të na japësh një fotografi të motrës për ta bërë portretin.

-Po sigurisht ja ku e ke. Dhe desha ta bëj pagesën tani.

-Po sigurisht, por paguaje vetëm gjysmën e çmimit,-tha Mia.

-Përse gjysmën e çmimit,- tha Marina. Sepse je blerëse e rregullt e jona, dhe tani më jë bërë shoqja jonë.

- Faleminderit shumë, jeni shumë të sjellshme.

-Faleminderit, edhe juve- tha Samanta.

Pas asaj Samanta me Mien ishin lodhur shumë dhe Samanta tha;-

Mia qëndro këtu, unë do shkoj të blej diçka për të ngrënë, fundja sot jemi lodhur shumë.

-Në rregull ja ku i ke paratë. Jo ushqimi sot është nga unë,-tha Samanta.

-Mirë faleminderit.

Samanta kur shkoi të blej ushqim, te Mia erdhën disa blerës, e përshëndetën dhe e pyetën se a e dini se ku jeton Samanta?,

-Përse çfar ju duhet?- i pyeti Mia.

-Ne jemi prindërit e saj, ardhjen tonë këtu pa paralajmëruar ia kemi bërë surprizë, nuk e di që ne jemi këtu.

-Më falni se reagova kështu, por nuk e dija se kush jeni.

-Samanta është shoqja ime e ngushtë, ne punojmë këtu. Tani shkoi të blej dicka për të ngrënë, tani do kthehet.

-Nuk ka lidhje se reagoje ashtu, të kuptova, doje ta mbroje shoqen tënde, më pëlqeu veprimi yt,- tha Leonardo.

-Mu bë shumë qefi që Samanta ka një shoqe si ti, dhe se paska aritur ta realizoj ëndrrën e sajë.

-Më falni harova të prezantohem, unë jam Mia.

-Gëzohem, unë jam Xhakarta.

-Ndërsa unë jam Rosita shoqja dhe motra e Samantës.

-Gëzohem ,- tha Mia.

-Ndërsa kjo mace e vogël e kujt është,- pyeti Rosita. Më pëlqejn shumë macet.

-Kjo është macja e Samantës. Luna e quajnë, me të vertet është shumë e ëmbël dhe e lëvizshme.

-Qenka shumë e mirë.

Në ndër kohë duke biseduar erdhi Samanta.

-Xhaxhi Leonardo.....tha Samanta e shokuar, teta Xhakarta, Rosita u gëzova shumë, çfar surprize, më gëzuat shumë, më paska marë malli shumë për juve , -tha Samanta dhe nga emocionet filloi të qajë, dhe pastaj i përqafoi.

-Samanta, ti the se u gëzove, pse qanë tani , - e pyeti Xhakarta.

-Më kishte marrë shumë malli për ju, dhe u ndjeva shumë mirë kur iu pash.

-Në rregull Samanta, mos u mërzit, na ke neve dhe u gëzova shumë për punën që ke berë,- tha Rosita.

-Faleminderit që erdhët.

-Mos fol ashtu, ne jemi familja jote, kemi ardhur vetëm për një javë dhe do shkojmë sepse Rosita është në shkollë pastaj.

-Faleminderit që keni ardhë, ejani tani të shkojmë në shtëpi sepse me siguri jeni lodhur dhe jeni të uritur.

-Mia më fal shumë por duhet të shkoj patjetër në shtëpi.

- Po sigurisht mund të shkosh, mos u brengos do t'ia dal mbanë unë.

-Faleminderit shumë.

- Mos fol kështu, të kuptoj nuk mund t'i lësh ti vetëm prindërit. Tani shko se ty të presin, shihemi.

-Mirë shihemi. Luna eja shkojmë në shtëpi.

Ndër kohë familja dhe Samanta aritën në shtëpi. Samanta filloi të prëgadis darkën. Pasi e përgaditi darkën të gjithë u ulën në tryezë, e Samanta tha;- Kjo është darka dhe dita me e mirë që e kam përjetuar, kësaj i thonë familje.

-Edhe për ne, kjo është dita më e bukur.

Të gjithë të lumtur hëngrën darkën si një familje e vërtet. Diell i pranverës ishte shumë edhe në të perenduar, lulet filluan të lëshonin aromën e tyre të këndshme, ndërsa ditët kalonin. Ishin bërë pesë ditë që Xhakarta, Leonardo dhe Rosita kishin ardhur në Milano dhe dy ditë shkonin përsëri në Amerikë. Koha për to kaloi shumë shpejt.

-Teta Xhakarta pse nuk qëndroni edhe pak ju. Edhe dy ditë shkonin, dhe unë ende nuk jam çmallur me ju.

-Samanta bijë, po atje kemi punë, kemi lënë gjithë ato punë, e ato na presin neve. Gjithashtu edhe Rosita për pesë ditë fillon shkollën sepse kanë pasur pushim.

-Ti mund të vish kur të duash, gjithmon e ke derën hapur, nuk mund vetëm ne të vijmë të të vizitojmë.

- Sigurisht kur të kem kohe të lirë sigurisht që do vij. Por gjithmonë me macën time, Lunën , - tha Samanta.

-Po sigurisht, edhe pse s'më pelqejnë macet, këtë e kam shumë qef, është shumë e bukur dhe e mirë.

-Po ashtu është, -tha Samanta.

-Sidoqoftë unë tani do shkoj në punë, ju nuk jeni të huaj këtu, merrni çfar të doni dhe bëni çfar t'iu doj zemra, të mos iu vij turp.

- Në rregull bijë, po a nuk është herët, është ende mëngjes, dhe askush nuk vin të blej që në në këtë orë.

-E di, po ne shkojmë më heret dhe i bëjmë disa piktura, deri sa të vijnë klientet. Dhe kam një kërkesë, teta Xhakarta.

-Po sigurisht, urdhëro.

- A mundet sot të kujdesesh për Lunen, është duke fjetur nuk mund ta zgjoj për kot, gjithsesi atje nuk bën asgjë vetëm sillet rreth nesh.

-Po sigurisht, me dëshirë, madje edhe Rosita shumë e do, do argëtohen bashkë.

-Në rregull falemenderit atëher, unë të dal që të mos vonohem, se me pret Mia.

-Po sigurisht shihemi.

-Shihemi.

Samanta doli e shkoi në qendër, aty u takua me Mien.

-Mirmëngjesi Samanta, kam lajme shumë të mira.

- Mirmëngjesi Mia, çfar lajme, më trego.

-Dje unë mbeta e fundit këtu sepse bëra edhe një pikturë. Në ndër kohë erdhi një grua shumë e pasur e me tha; -A mund të mi bëni dy portrete, mi dha fotografitë.

-Me të vërtetë u gëzova shumë.

- Dhe a e din se sa do paguhemi?

-Sa, - pyeti Samanta.

- Një portret që do e bëjmë vlen sa dhjetë piktura që ne kemi bërë. Ndërsa dy portrete vlejnë sa njëzet piktura.

-Ka njerëz që vlersojnë më shumë se ç' duhet punën tonë,- tha Mia, dhe qeshi.

-Kjo është një shumë e madhe, do mund ta hapim edhe një kurës. Do i mësojmë njerëzit si të pikturojnë.

-Po është ide shumë e mirë dhe me paratë tjera që kemi punuar do i blejmë ngjyrat, tabelat, kariket e gjithçka tjetër .

-Do bëhet shumë mirë, por nuk mund ta hapim në fshat sepse fshati është i vogël, nuk do ketë shumë adhurues që do donin të pikturonin, -tha Samanta.

-Në rregull do dalim jashta fshatit që ta din edhe ato për punën tonë se çfar bëjmë ne,- tha Mia.

-Është ide shumë e mirë, kjo punë na solli shumë fat neve.

-Po ashtu është.

Ndër kohë ato duke biseduar i a filluan punës me portretet që i kishte porositur gruaja e panjohur.

-Samanta, unë gruas që i porositi portretet ia dhash numrin e telefonit tim, sepse ajo tha,- Do kontaktojmë, e nesër do vinte të mer porosinë.

-Kemi kohë deri nesër, mendoj se kjo do jetë dita e jonë e fundit në qendër sepse mund të kemi atelienë tonë,- tha Samanta.

-Shpresojmë,-ia ktheu Mia.

Erdhi mesdita, koha ishte shumë e mirë ndërsa dy shoqet nuk ndalonin së punuari. Për Miën dhe Samantën ishte një ditë shumë e mirë sepse morën edhe një lajm shumë të mire, që do ua ndryshonte jetët. Në vazhdim do shihni fatin e Miës dhe Samantës.

LARGIMI I XHAKARTËS, LEONARDOS DHE ROSITËS

Ditët kaluan shpejt, ishte dita e fundit e Samantës që kalonte me prindërit, sepse ato nesër niseshin për në Amerikë. Samanta ishte e mërzhitur se kishte kaluar shumë pak kohë me to, e kishte kaluar më shumë kohë në punë.

-Rosita mirmëngjes, unë tani do shkoj në punë për t'i shitur dy portrete, sepse ka ardhur blerësi dhe pastaj do vij në shtëpi.

-Mirë në rregull, por a mund të vij edhe unë me ty, shumë pak kemi qenë bashkë.

-Sigurisht mund të vish, vetëm unë thash, të mos bezdisesh atje duke pritur.

-Jo madje do kënaqesha shumë.

-Në rregull eja tani të dalim.

-Në rregull.

Kur shkuan atje panë Miën se kishte shkuar para tyre.

-Përshëndetje Rosita, si je.

-Mirë Mia, ti si je?.

-Mirë, ja po ju prisja juve. Tani do vijë ajo zonja, tha se për sot do takohemi këtu.

-Në rregull atëher këtu do presim. Kaluan dhjetë minuta kur dikush e thiri Miën në telefon.

-Kush ishte,- pyeti Samanta? Nuk e di, se kam të regjistruar këtë numër.

-Përshëndetje, kush është,-e pyeti Mia.

-Përshëndetje, unë jam Anxhela, jam ajo që iu porosita dy portrete a iu kujtohem!.

-Po sigurisht zonja Anxhela ne jemi duke iu pritur këtu, kur do vini t'i merrni pikturat?

-Ja pikërisht për këtë iu telefonova që sot nuk mund të vij ti mar portretet, me doli një punë, më falni shumë që iu mora kohë.

-Jo as që bëhet fjalë, por ju lutem na tregoni kur do vini t'i merrni.

-Po sigurisht, nesër pas dite do jem aty, në qendër të fshatit.

-Në rregull ju faleminderit,-tha Mia.

-Faleminderit edhe ju për mirëkuptim, shihemi.

-Çfar tha zonja Anxhela, e pyeti Miën, Samanta.

-Tha që sot nuk mund të vij ti merr portretet, nesër pas dite do vij t'i merr .

-Në rregull, atëher si thua sot mos punojmë, ta shëtisim pak Rositen rreth Milanos.

-Po mundet.

Samanta, Mia dhe Rosita shkuan të shëtisin nëpër Milanon.

Shkuan në shopping, pastaj hëngrën ushqim dhe më në fund u kthyen në shtëpi.

-Ishte një ditë shumë e bukur, faleminderit për gjithçka.

-Ç'është ajo fjalë, ti je shoqja ime, ndërsa këtë qafore do e kesh një kujtim nga Milanoja.

-Madje edhe Xhakartës dhe Leonardos u kemi blerë diçka që t'i kenë kujtim nga ne.

-Faleminderit për gjithëçka,- tha Rosita.

-Ska gje.

Duke biseduar aritën në shtëpi, pastaj hëngrën darkën dhe ranë më herët sepse nesër niseshin për në Amerikë. E nesërmja erdhi shumë shpejt. Samanta filloi të përshendetet me familjen e saj.

-Samanta do na mungosh shumë, dhe ne të mirpresim edhe ty që të vish në Amerikë.

-Sigurisht kur të kem kohë të lirë do t'iu vizitoj.

-Rosita edhe ti eja sa të dilni nga shkolla, në rregull?.

- Në rregull, Xhaxhi Leonardo, edhe ti gjithashtu e ke derën hapur.

- Faleminderit bijë, u kënaqëm shumë, të mirpresim edhe ty.

-Edhe unë u kënaqa shumë me ju,-tha Samanta.

Samanta përshendeti familjen e saj, ato u nisen për në Amerikë, ndërsa Samanta morri rrugën për në punë.

MË NË FUND ERDHI ZONJA ANXHELA TI MER PORTRETET

Pasi Samanta u përshëndet me prindërit shkoi në punën e sajë. Si gjithmonë u takua me Miën.

- Mia, a erdhi zonja Anxhela?

- Samanta, jo ende ska ardhur, eja të ulemi këtu ta presim.

-Në rregull. Pas një ore pritje erdhi zonja Anxhela.

Ishte një zonjë me shumë stil dhe ishte shumë e bukur.

-Përshëndetje zonja Anxhela, si jeni,-tha Mia.

-Përshëndetje, faleminderit jam mirë.

-Përshëndetje Zonjë e nderuar, unë jam Samanta, bashkëpunoj me Miën.

-Përshëndetje, gëzohem, unë jam Anxhela. A i keni përfunduar portretet që ua kërkova?

-Po sigurisht Zonjë,- tha Samanta, ja ku i ke.

- Kush e ka pikturuar këtë?

- Unë zonjë,- tha Samanta, ndërsa atë tjetrën Mia.

- I paskëshi bërë shumë më të bukura se sa e prisja, dhe për këtë do paguheni sa dyfishi i gjitha pikturave, sepse këto portrete që keni bërë janë shumë të rëndësishme për mua.

- Ju faleminderit - thanë të dyjat.

-Ja ku i keni parat, iu shkoftë dita mbarë.

-Ju faleminderit zonjë, shpresoj të takohemi përsëri.

-Shihemi.

Pasi zonja Anxhela shkoi, dy shoqet filluan të bisedojnë mes veti.

- Uaa, këto janë shumë para, mund ta blejmë një dyqan shumë të bukur.

- Po ashtu është,-tha Samanta. Si thua të dalim të kërkojmë ndonjë dyqan tani.

-Mia nuk e din se sa jam e gëzuar, edhe pse nuk e kryem shkollën kjo punë na dha shumë fat.

-As pa ndihmën tënde s'do ia dilja, ti je një shoqe besnike dhe shumë mirë, je më teper se një motër,-tha Samanta.

-Edhe ti për mua je e njejtë,- tha Mia dhe e përqafoj Samantën

përzemërsisht.

-Po Luna ku është,- pyeti Mia? Ooo e kam haruar në shtëpi duke fjetur. Dola nga shtëpia duke u ngutur, me siguri atëherë e kam haruar. E din e dua shumë Lunën është një mace e veçant për mua dhe ende s'mund ta haroj atë ditë kur e gjeta. Atëherë si thua parat e para ti harxhojmë për t'i bler Lunës një dhuratë.

-Është ide shumë e mirë.

Pasi i blenë një dhuratë Lunës, ato shkuan në shtëpi dhe e gjetën duke mjaullli.

-O Luna më fal që të harova isha e ngarkuar shumë me punë, shiko e kam një dhuratë për ty, ja shiko.

Macja e vogël mjaulliu.

- Mia si thua, të dalim të festojmë këtë lajm të bukur?

-Mundet, por do e marim edhe Lunën.

-Po patjetër këtë herë nuk e haroj në shtëpi.

Samanta, Mia dhe macja Luna dolën të festonin për dyqanin që do e blenin. U zbavitën shumë. Më së shumti u zbavit Luna. E dini pse? Sepse takoi një macë tjetër atje.

HAPJA E KURSIT TË VIZATIMIT

Pas asaj nate të bukur që kaluan, erdhi edhe dita ku do e blenin dyqanin. Ishte pas dite kur Samanta vendosi të takohej me Mien në parkun e qytetit.

-Përshendetje Samanta, çkemi, si je?

-Përshëndetje Mia, faleminderit jam mirë dhe ti dukesh mirë . Pas asaj nate që kaluam, si mund të mos jemi mirë.

-Samanta qeshi. Po ashtu është, por më së shumti është argëtuar Luna sepse gjeti një shoqe atje.

-Po ashtu është.

-Mirë atëher Mia, unë kam gjetur disa lokale, si thua të shkojmë t'i shohim?

- Po sigurisht.

Samanta dhe Mia shkuan të kërkonin lokal të përshtatshëm për punën e tyre. Pikërisht duke kërkuar lokalin, afër firmes se Mirandës ishte një lokal në shitje.

-Samanta shiko, si thua ta marrim këtë lokal, është i madh i ri dhe shumë i bukur, gjithashtu edhe në qendër të vëmendjes është, si thua?

-Po me të vërtetë është shumë i bukur, është i madh, gjithashtu edhe Tetën Miranda do e kemi afër.

-Po ashtu është, eja të shkojmë ta pyesim sa kushton.

Samanta dhe Mia shkuan te shitsi, i thanë se donin ta blenin këtë lokal. Shitësi u çudit kur e pa se ato ishin në moshë të re dhe dëshironin të blenin lokalin. Gjithsesi shitësi ua tregoi çmimin. Ato i kishin paratë dhe e blenë lokalin.

-Na qoftë me fat ky lokal,- thanë dy vajzat.

-Si thua të fillojmë ta rregullojmë mbrenda?

-Po, por së pari të shkojmë t'i blejmë gjërat dhe ta rregullojmë mbrenda.

Samanta me Mien shkuan dhe kishin blerë shumë gjera; drasat për të vizatuar nxënësi që do ndiqnin kurse, ngjyrat, brushat kariket e shumë gjëra të tjera. Të dyja filluan ta rregullonin lokalin, doli shumë bukur kur të gjitha gjërat u rënditen nëpër vendet e tyre, u bë si një kurs i vertetë.

Pas pak erdhi Miranda të shihte se kush vendosej afër saj. Kur pa Samanten dhe Mien, u gëzua shumë.

-O vajza çfar bëni ju këtu, gëzohem shumë që iu shoh.

-Suprizë, ne e blemë këtë lokal, në të cilin do të hapim një kurs për të vizatuar.

-Me të vertetë, ta gëzoni, tani do iu kem edhe unë afër juve .

-Po ashtu është, faleminderit. Si thoni të festojmë këtë lajm?

-Edhe ashtu është erësuar, dhe neser vazhdojmë me punët tjera.

Miranda, Samanta dhe Mia dolën të festonin për këtë lajm të mrekullueshem, u argëtuan shumë. Po Luna ku ishte?

Samanta e kishte haruar përsëri në shtëpi.

KURSI SJELL FAT PËR SAMANTËN DHE MIËN

Erdhi vera e bukur, dielli ndriçonte sikur më parë, pikërisht në këtë ditë të bukur ishte hapja solemne e Kursit të vizatimit. Samanta, Mia gjithashtu edhe Luna ishin shumë të gëzuara.

-Samanta, nuk më besohet, shiko ku kemi aritur, edhe pse se përfunduam shkollën, ne aritëm shumë me talentin tonë.

-Tani a je e gëzuar që e realizove ëndrrën?

Po, unë jam e gëzuar për punën që bëjmë, ndërsa ëndrra ime ishte të kisha kompanin time, e të bëja dizaine, të vizatoja fustane njejtë si puna e Mirandës. Por fatkeqësisht na përjashtuan nga shkolla.

-Të kuptoj, por mos u mërzit, ti kalove shumë gjëra dhe besoj se do e realizosh edhe këtë ëndërr.

- Shpresoj, por edhe për këtë kurs jam shumë e lumtur.

Ndër kohë zonja Miranda i kishte dëgjuar se çfar po flisnin, i erdhi keq për Samantën. Megjithë, ato ishin shumë të gëzuara, ishin mbledhur shumë njerës për hapjen e këtij kursi, kishte ardhur edhe Nëna e Miës. Të gjithë festuan së bashku, e më së shumti ishin të gëzuara Samanta dhe Mia, sepse ato ishin shefet e kursit, e ato kishin kontribuar më së shumti në atë vend.

-Samanta, Mia kjo është dhurata ime për ju,- tha Miranda.

-O faleminderit shumë, kjo është dhurata e parë dhe do e vendosim këtu në klasën e kursit. Samanta hapi dhuratën, ishte një vazo, te e cila kishin shkruar emrat e Samantës dhe Miës. Ajo ishte si një llogo e kursit e shkruar në vazo.

-Ooo kjo është shumë e bukur, faleminderit do e vëmë këtu afër derës, që të gjithë kur të hynë brenda, ta shohin, kjo sigurisht që është dhurata më e bukur që e kemi marrë,- thanë Samanta dhe Mia.

-Ju meritoni më shumë se kaq.

-Kjo vazo simbolizon fuqin e dy shoqeve që kanë luftuar për ti realizuar ëndrrat e tyre, dhe u jep shembull të gjithë atyre që dëshirojnë t'i realizojnë ëndrrat e tyre.

-Faleminderit shumë,-tha Mia.

-Faleminderit Zonjë, edhe ti je shembull për ne,- tha Samanta.

-Miranda buzeqeshi dhe tha , -Atëher unë të shkoj se kam pak punë, duhet të shkoj tek mjeku.

-Pse Zonjë mos jeni e semurë, na tregoni?

-Jo nuk është asgjë serioze, bëra disa analiza dhe duhet të shkoj t'i marr.

-Në rregull atëherë shihemi. Shihemi. Pas hapjes solemne, të gjithë shkuan në shtëpi. Ndërsa të nesërmen fillonte kursi. Erdhi e nesërmja, Samanta dhe Mia ishin duke u bërë gati për punë.

-Luna me lë vetem pesë minuta të behëm gati pastaj do të jap ushqimin, e ke aty afër te shtëpiza jote e vogël. Luna vazhdonte të mjaullinte dhe nuk e lente të qetë Samantën.

-Nëse vazhdon të bësh kështu, nuk do të marr me vete, atëher macja sikur e kuptoi dhe shkoi në shtëpinë e saj.

Samanta pasi u bë gati, shkoi t'ia jepte ushqim Lunës.

-Ja ku e ke ushqimin.

Pasi hëngri macja e vogël ushqimin atëherë dolën dhe shkuan në kurs. Atje u takuan me Mien. Samanta me Mien dhe Lunën sa hyrën brenda në atelie, menjëher filluan të vinin nxënës për t'u regjistruar në kurs.

-Mirdita në kemi ardhur për tu regjistruar, a është ky kursi i ri që është hapur?

-Po po ky është, urdhëroni. Atëherë mi jepni të gjithë emrat t'iu regjistroj këtu në kompjuter!.

Te gjithë ua treguan emrat dhe pastaj filluan.

Mia dhe Samanta i ndanë nxënësit në dy grupe. Pasi që ishte kursi i madh kishte tre klasa. Në njëren klasë u fut Samanta me nxënësit, dhe në tjetrën Mia me nxënësit. Ato dyja kishin blerë dhe dy ditar dhe shkafe ku nxënësi ti vendosnin aty emrat e tyre dhe të gjitha punimet, do i vendosnin atje.

-Në rregull nxënës mirë se vini në kursin e vizatimit. Ju jeni nxënësit e parë që keni ardhur, dhe shpresoj të na sillni fat.

-Faleminderit, bërtitën nxënësit.

Gjithashtu edhe Mia mbajti të njejtin fjalim.

-Në rregull atëher të fillojmë me punë. Tema për sot është si të bëni një llogo tuajën, jo ti merni llogo tjera, vetë ti bëni.

Në rregull thanë nxënësit, ndërsa Samanta u dha një detyrë tjetër.

Tema për sot është; Temë e lirë , e zgjedha këtë temë për të mos iu ngarkuar që në ditën e parë.

-Faleminderit profesoresh,-bërtitën nxënësit .

Pasi mbaroi ora, Mia ua kontrolloi të gjithëve vizatimet. Kishin dalë shumë vizatimet e bukura gjithashtu edhe Samanta. Pasi mbaruan me mësim nxënësit shkuan në shtëpi, ndërsa Samanta me Miën po bisedonin.

-Si thua të vëmë një tabelë para kursit?

-Çfar table, pyeti Mia?

-Pra prej moshës dymbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjet mund të vijmë të aplikojmë për t'u regjistruar.

-Është ide e mirë, në rregull do e vendosim.

Tani dy piktoret e reja i njihte gjithë Milanoja për punën që bënin.

Që prej ditën e parë patën shumë fat, por dhe ishin lodhur dhe pas punës shkuan në shtëpi të pushonin. E pra me punë dhe mund arihet gjithçka.

SAMANTA DHE MIA U SHPËRBLYEN PËR PUNËN E TYRE

Ditët në kurs kalonin shumë mirë. Çdo ditë shtohesh nga një nxënës me tepër. Samanta me Miën ishin të kënaqura me rezultatet e punës. Kjo një ditë, do të ishte një ditë shumë e bukur, dhe e veçantë për Samantën dhe Miën. E dini pse është kjo ditë e veçantë ? Nëse e lexoni deri në fund shkrimin do ta kuptoni. Do të jetë një surprizë shumë e bukur. Atë ditë, si çdo ditë tjera, Samanta dhe Mia shkonin në kurs për t'u dhënë nxënësve mësim.

-Përshëndetje Mia.

-Përshëndetje Samanta.

-Mia e din, sot kam një ndjenjë sikurse do të ndodh diçka shumë e bukur.

- Po Samanta, edhe unë kam parandjenja se sot do të ndodh diçka e mirë, kjo verë na solli shumë surpriza.

-Po ashtu është,- tha Samanta.

Pikërisht në orën dymbëdhjetë filloi mësimi, e mbaroi në orën katërbëdhjetë. Pastaj vinte orari i dytë prej në ora pesëmbëdhjetë deri në shtatëmbëdhjetë, vinin nxënësit e grupit tjetër. Ora përfundoi, Samanta me Mien bëheshin gati ta mbyllin kursin, kur papritmas erdhi një grua me emrin Diana.

-Përshëndetje, a jeni ju Samanta dhe Mia?

-Të frikësuar vajzat u përgjigjën,- Po ne jemi.

-Atëher unë jam Diana.

- Na bëhet qejfi.

-Edhe mua, tha zonja Diana.

-Mos u frikësoni, mua këtu më ka dërguar nga Ministria. Ato kanë parë talentin dhe punën tuaj që keni aritur në këtë moshë, dhe kanë vendosur t'iu shpërblejnë me një shumë të madhe të parave.

- Faleminderit është diçka shumë e mirë nga ana e juaj .

-Ja ku i keni parat.

Parat ishin të vendosura me një zarf të bardhë dhe në dorë me një buqet me lule.

-Faleminderit, ditën e mirë, mirëupafshim dhe punë të mbarë,

suksese në të ardhmen.

-S'mund ta besoj Mia, ky lajm është shumë i mirë.

-Po as unë s'mund ta besoj.

- Si thua, me këto para të shkojmë diku ne pushime,- tha Samanta.

Nuk e di, nëna ime se a do të pranoj një gjë të tillë, sepse Babi i kishte vdekur Miës.

-Në rregull kur të shkosh në shtëpi, pyete dhe më trego.

-A e dini cila ishte përgjigja e Nënës së Miës? Do të shihni në kapitullin tjetër, deri atëher lexim të këndshëm.)

VENDIMI I NËNËS SË MIËS PËR PUSHIMET

Mia pasi shkoi në shtëpi e pyeti Nënë e sajë, Nënë a do të më lejosh që Unë me Samantën të shkojmë diku në pushime, sepse Ministria kishte vendosur për punën ne që kemi bërë të na shpërblejnë me një shumë të parave edhe ne dëshirojmë të shkojmë në pushime.

- Me të vertetë u gëzova shumë për punën, ndërsa për pushime nuk e di, nvalet se sa do qëndroni.

- Nuk do qëndrojmë shumë, një javë, dhe do kthehemi edhe ne se kemi shumë punë këtu, si thua?.

-Në rregull bijë mund të shkosh, por do me ngelet mendja te ti. Unë kam besim te ti dhe tek shoqja jote, e cila duket se është një vajzë e mirë.

-Me të vërtetë me lejove, faleminderit shumë.Samanta është një shoqe shumë e mirë, dhe Unë kam besim te Ajo.

Në të njejtën kohë e përqafoi nënën e saj.

-Bijë unë jam turpëruar me ju, ende nuk kam ardhur t'iu përgëzoj për atelienë dhe shkollën, e din kam shumë punë.

- E di nënë mos u brengos, tani unë dua të të jap ca para dhe të lutem meri.

-Unë mendoj që nuk duhet të punosh më, puna ime mjafton për ne të dyja dhe vëllaun.

-Jo bijë unë ato para nuk mund t'i marr, ti i ke fituar me mundin tënd dhe të takojnë ty.

-Jo të lutem meri këto, si një shenjë falemenderimi për të gjithë ato gjëra që bën për mua.

-Mia, faleminderit bijë, më bën të ndjem krenare për ty.

E përqafoi Miën. Mia i dha një shumë të parave.

-Nënë, unë mendoj që edhe ti dhe vëllau keni nevojë për pushime, pse nuk shkoni edhe ju diku.

-Është ide e mirë, mundet. Në rregull, unë atëher të shkoj t'i bëj robot gati, sepse nesër nisemi. Mia pastaj i telefonoi Samantës.

- Samanta çkemi.?

-Çkemi Mia.

-Kam lajme shumë të mira, nëna ime më lejoi të shkojmë bashkë në

pushime.

-Ashtu shumë mirë edhe nuk jemi të vogla, kemi tetëmbëdhjetë vjet, jemi të ritura.

-Me të vertetë u gëzova shumë, atëher nesër nisemi për pushime diku ne detë, mendoj të shkojmë sepse edhe koha tani është e nxehtë.

-Po, është ide e mirë, atëherë nisemi nesër.

-Shihemi.

-Shihemi.

Samanta dhe Mia filluan të bëheshin gati.

- Luna, mos u brengos, do të mar edhe ty, ndoshta do gjesh ndonjë shoqe atje,- thoshte Samanta. Do të zbavitemi shumë, do të shkojmë në detë, atje do ketë rrrerë, plazh do argëtohem shumë.

Ty duhet të të marr ushqim me vete sepse atje mund të mos ketë dhe pastaj të ngelesh e uritur.

Të dyja shoqet ishin bërë gati, e nesër niseshin për pushime. Vera për to filloi tani.

SAMANTA, MIA DHE LUNA NË PUSHIME

Shpejt erdhi e nesërmja, dy shoqet ishin shumë të gëzuara sepse do shkonin bashkë në pushime. U zgjuan herët, u nisen për në pushime. Në mëngjes Miën e priste një surprizë. Nëna e sajë i kishte blerë një makinë të vogël, me të cilën vendosën të shkonin në pushime.

-Mia s'më tregove që ke makinë, ta gëzosh,- i tha Samanta.

-Faleminderit Samanta, ma bleu nëna ime si dhuratë për kursin që kemi hapur.

-Ashtu shumë mirë.

Ato filluan herët në mëngjes, dhe aritën pas drake.

-Qenka shumë vend i bukur,- tha Samanta.

-Po ashtu është. Shpejt morën një dhomë në hotel për të pushuar se bënte shumë vapë.

-Edhe hoteli qenka shumë i bukur, e mund ta shohim gjithë detin nga dhoma .

-Po ashtu është.

-Luna ti sje lodhur fare,- tha Samanta.

-Luna mjaulliu.

-Tani ne do të pushojmë pak, pasi që harova ta marr krevatin tënd, do duhesh të flesh me mua këtu në krevat.

Në apartamentin e hotelit kishte dy krevate, një kuzhinë, një banjo dhe një dhomë. Pasi pushuan, jashtë ishte erësuar, ishte ora tetë e mbrëmjes.

- Darkën sonte ta hamë diku jashtë,-tha Mia.

-Mundet.

Samanta dhe Mia u regulluan dhe dolën të hanin darkë. Lunën e lanë në hotel, sepse ajo ishte duke fjetur, dhe u vinte keq ta zgjonin. Të dyja pasi hëngrën darkë, blenë disa gjëra dhe ushqim për Lunën.

-Me siguri është uritur macja ime e vogel, eja të shkojmë në banesë.

- Në rregull, tani do shkojmë.

Dhe e dini se çfarë ishte duke bërë Luna, kur ato shkuan në hotel? Ajo ende ishte duke fjetur.

-Kot shpejtuan, e shikon ende fle Luna,- tha Mia me zë të ulët.

-Në rregull më fal.

Pastaj edhe ato të dyja i zuri gjumi sepse ishin lodhur, por këtë herë nuk ishin të lodhura nga puna, por nga shëtitja që kishin bërë, ndërsa Luna ajo e vazhdoi gjumin. Këtë natë u kënaqën shumë. Vallë a do argëtohen edhe ditet tjera?

SI KALONIN PUSHIMET

Ishin bërë dy ditë që Samanta dhe Mia ishin në pushime. Ishin duke kaluar shumë mirë. Këtë mëngjes vendosën të zgjoheshin herët e të shkonin në plazhë.

-Si thua të shkojmë të marim një ngjyrë tjetër të trupit, edhe dielli sot nxeh shumë,- tha Mia.

-Në rregull të vishem dhe vij.

-Në rregull, - u përgjigj Mia.

Samanta u bë gati dhe shkuan në plazh, dhe e dini se çka ndodhi? U ndodhi një gjë shumë e bukur. Aty afër ishin dy vajza rreth moshës gjashtëmbdjetë vjeç. U afruan afër Miës dhe Samantës.

-Përsëndetje, a jeni ju dy piktoret që keni hapur atë kursin e vizatimit ? Kemi dëgjuar shumë për ju, jeni të mrekullueshme me punën që bëni.

-Faleminderit vajza.

-A punoni edhe tani ?

-Jo tani kemi ardhur në pushime por nëse dëshironi të regjistroheni në kursin tonë, po ua japin numrin e telefonit për kontakt.

-Faleminderit, unë jam Kanita,

-Ndërsa unë jam Kiara.

-Gëzohemi që u takuam.- thanë Samanta dhe Mia.

-Edhe ne gjithashtu gëzohemi që paskëshi informate mbi punën tonë, ju jemi falemenderuese për fjalët e mira.

-Në rregull atëherë shihemi në kurs.

-Shihemi.

Samanta, shiko jemi bërë të famshme me punën tonë, shiko sa shumë njerës na njohin dhe e pelqejn punën që ne bëjmë.

-Po ashtu është, shumë u gëzova kur ato dy vajzat erdhen dhe na dhanë komplimente për punën që ne bëjmë.

-Po edhe unë u ndjeva shumë mirë, e din pse, sepse askush nuk na ndihmoi që të arrim deri këtu, dhe nuk thonë njëzëit fal dikujt Samanta me Mien aritën këtu, por thonë Samanta dhe Mia aritën diku vetë me mundin e tyre.

-Po ashtu është.

Pas plazhit Samanta dhe Mia shkuan të bënin shopping, blenë shumë rroba të bukura, dhe po i kalonin pushimet shumë mirë, por puna si la të qetë edhe në pushime sepse njerëzit kur i takoni u thonin,- A mund të na pikturoni diçka.

Tash me ato dy shoqet që njëherë ishin pa shpresë, tani i njihnin të gjithë për punën e tyre të mrekullueshme. Ndërsa Luna, e dini ajo për çfar ishte e famshme? Ajo vetëm flinte dhe të gjithë që e njihnin, i thonin Macja gjumashe.

PUSHIMET MBARUAN SHPEJTË

Ditët kaluan shpejt, koha ishte shumë e mirë, dielli i nxehtë shumë, bënte shumë vapë. Samanta dhe Mia nesër largoheshin, shkonin përsëri në shtëpi sepse i priste puna.

-Samanta pse nuk e vazhdojmë edhe tre ditë pushimin, jemi duke u kënaqur shumë?

-Jo Mia, ne duhet të kthehemi, madje shumë kemi ndenjtur, na presin gjithë ato punë.

-Of në rregull, në rregull,- tha Mia. Por sot do argëtohem shumë, sepse është dita e fundit.

- Si thua sot të shkojmë në ndonjë lokal nate?

- Nuk e di, do shohim.

Dita kalonte mirë, derisa Luna nuk humbi.

-Mia, Luna s'është këtu, ka humbur, ku do ta gjejmë ?

-Në rregull mos bën panik është këtu diku.

-E kërkuan gjithë andej, e më në fund e gjetën në një park afër hotelit, aty ishte me një mace tjetër.

-Luna ku na humbe kështu. Oh sa me frikësive, eja këtu.

- Eja të shkojmë në banesë.

Ato shkuan në banesë. Lunën e zuri gjumi, deri sa dy shoqet po bëheshin gati për të dalë.

-Do të kënaqemi e argëtohem shumë sonte. Po, por do kthehemi herët.

-Mia, si thua, që të mos shkonim në klub nate?

- Pse Samanta?

-Nuk më pelqejnë fare këto klube.

- Në rregull atëher të dalim darkën jashtë të hanim e pastaj të dalim në kinema,- si thua?

-Është ide e bukur. Të dyja pasi u bënë gati, shkuan të hanë darkë.

-Qenka shumë vend i bukur këtu, gjithashtu edhe ushqimet qenkan shumë të shishme, madje është buzë detit,- tha Mia.

-Po ashtu është, qenka një vend shumë i bukur është krejt drita.

-Po dhe në këso lloj ambientesh të bëjnë të ndjehesh mirë.

-Po vertët .

Pasi mbaruan darkën Samanta dhe Mia shkuan në kinema.

- Çfar filmi vallë të zgjedhim,- tha Samanta.

-Mendoj ndonjë komedi ,- si thua?

-Në rregull.

Të dyja hyrën në kinema të shikonin filmin. Atë natë u argëtuan shumë. Ishin lodhur aq shumë sa që kur shkuan në banesë, menjëher i zuri gjumi, por për fat të keq pushimet mbaruan. Nesër u nisën për në shtëpi. Gjatë rrugës panë shumë gjëra. Aritën shpejt në shtëpi, ishin shumë të lodhura dhe vendosen që nesër të shkonin në punë. Dhe pastaj ranë në një gjum shumë, shumë të thellë, gjithashtu edhe Luna si gjithmonë. Si thoni, a do donit edhe ju te kishit një mace si Luna dhe një pushim si Samanta dhe Mia? Shihemi në kapitullin e radhës, deri atëher mirëupafshim.

NJË MIKESHË E PAFTUAR NË KURSIN E VIZATIMIT

Pushimi mbaroi, ndërsa puna përsëri filloi. Tani dy shoqet, pas atij pushimit të mrekullueshëm ishin gati të fillonin me punën që i priste. Samanta duhej të punojë më shumë, e dini pse? Sepse ajo ende nuk e kishte realizuar atë që dëshironte. E mbani mend, ajo pëlqente të dizajnojë e jo të pikuroj. Por gjithsesi, Ajo kishte durim dhe besonte se një ditë do e realizoj ëndëren e saj. Dita kishte filluar mirë, koha ishte e freskët, dhe të gjithë në Milano mereshin me punët e tyre, vetëm se sot do të ndodh një gjë shumë e papritur.

-Dita sot është duke kaluar shumë mirë Mia!

-Po ashtu duket, -u përgjigj Mia.

Kishin ardhur edhe ato dy vajzat që i takuan ne pushim, e mbani mend. Dita kaloi mirë, vetëm deri sa nuk erdhi armikja e tyre, besoj e dini se për kë e kam fjalën. Erdhi Kanita, e mbani mend, ajo e cila u bëri një kurth për t'i larguar nga shkolla. Kanita kishte ardhur me dy shoqet e saja.

-Përsëndetje Samanta, përsëndetje Mia.

-Çfar kërkon këtu ti ?!! Më shpejt dil nga këtu sa nuk të nxora unë,- tha Mia.

- Op, me nga dalë, se pata me qëllim te keq, erdha t'iu uroj për këtë kurs të vogëëëël.

-Nuk na duhet urimi yt, të lutem dil jashta,-tha Samanta.

-Shiko ne të gjithë shkojmë në shkollë ndërsa ju mereni me kështu lloj dyqanesh të vogla si ky kurs i kotë...

-Atëher nga more veshit se kemi hapur kurs. Pikërisht nga njerëzit, sepse na njohin të gjithë për punën që e bëjmë, ndërsa ty të njohin për vjedhje, mashtrime dhe xhelozia që të verbon,- tha Mia.

Ndërsa Kanita e nervozuar i shikoi të dyja dhe tha:- Unë erdha vetëm që t'iu tregoja se tani të gjithë jemi te lumtur që ju nuk jeni në mesin tonë.

-Po, deri sa ti bëje plane të ma vidhje pikturën,- tha Samanta.

-Po ashtu është, tani më kjo nuk vlen sepse të gjithë iu kanë haruar juve,- tha Kanita .

- Ne jemi të kënaqura me punën që bëjmë nuk ka rëndësi se kush na

ka haruar e kush jo, ne jemi të kënaqura me punën tonë, ti sillesh si fëmijë e jo si një vajzë e rritur, të uroj të shikosh botën me sy ndryshe e jo me sytë e xhelozisë sepse gabohesh, dhe tani dil jashtë - tha Samanta.

- Në rregull, por ta dini se do të më shihni më shpesh këtu.

- Nuk e besoj, shpresoj se e din mirë çfar do të gjej, si të afrohesh afër kursit,- tha Mia.

-Do ta shohim, dhe tani mirupafshim , - tha Ajo duke qeshur.

- Shumë më nervozon kjo, e haruam, na doli përsëri përpara.

-Po ashtu është edhe dita na filloi mirë deri sa s'erdhi ajo,- tha Samanta, por frikësohem mos i bëj diçka kursit.

-Mos u brengos kemi vendosur kamera, nuk besoj se mund të bëj edhe një gjë të tillë,- u përgjigj Mia.

Pasi mbaruan me punë, të lodhura shkuan në shtëpi. Samanta ishte duke shikuar film me Lunën. Derisa trokiti dikush tek dera! Samanta doli të shihte se kush ishte, por e dini çka pa? Në kapitullin e radhës do të shihni që Samanta ishte nje hap afër realizimit të ëndrrës se saj!

ZONJA MIRANDA DËRGOI NJË ZARF

Samanta kur doli te dera, nuk ishte askush, për pos një zarfi që ia kishte dërguar zonja Miranda.

-Çfar është kjo, pse me ka dërguar zonja Miranda këtë zarf mua? Samanta e hapi dhe filloj ta lexonte ku aty shkruante:

“E dashur Samanta shpresoj të jesh mirë me shëndet. Këtë letër e kam shkruar pikërisht për ty. E mban mend, atë ditë kur thash se duhet të shkoj t’i mar analizat, pikërisht atë ditë mësova se kisha edhe shumë pak kohë për të jetuar, vuaja nga sëmundja e zemrës dhe se njëra nga mushkërit është kalbur. Më kanë ngelur edhe pak kohë për të jetuar. Unë nuk kam femijë e as familje, jam e vetme dhe pikërisht mendoja se kujt do ia lija kompanin Design Collection, e më shkoi mendja tek ti. Unë dëshiroj që kompaninë të ta dhuroj ty, e di që ti nuk do pranosh, por të lutem pranoje sepse nuk ka tjetër njeri që i besoj t’ia dorëzohj firmën. Të kam zgjedhur pikërisht ty, e din pse? Prej ditën e parë që unë të takova, shihja një vajzë guximtare, besnike që lufton deri në fund për atë që dëshiron, shihja një vajzë që nuk dorëzohet aq lehtë, dhe pikërisht një njeri i tillë i nevojitet kësaj kompanie. Besoj se tani je duke e mbajtur letrën në dorë dhe duke e lexuar, e pyet veten se çfar kam bërë unë për ta merituar atë kompani. Të njoh shumë mirë edhe pse jemi njohur për pak kohë. Ti nuk ke bërë asgjë për atë kompani, por besoj me gjithë zemër se do bësh shumë e shumë gjëra në të ardhmen për atë kompani. Ti e meriton, prandaj të zgjedha ty. Dhe nëse e pranon do më bëhet shumë qejfi, dokumentet për nënshkrim i ka zotëri Sebastiani. Nëse shkon nesër në firmë, dhe thua që më ka dërguar zonja Miranda, ai do t’i jep të gjitha dokumentet ...”

Nga unë Miranda.

Samanta pasi e lexoi letrën u habit, si mundet që të jetë aq e sëmur zonja Miranda, çfar do bëj unë tani, nuk mund ta pranoj një gjë të tillë, nuk e meritoj unë atë kompani thoshte ajo me vete. Oh zonja Miranda nuk di se ç’të bëj. Duhet të shkoj ta takoj dhe ti them që s’mund ta pranoj një ofertë të tillë. Samanta ndjehej shumë keq, vendosi ta thëriste Mien.

-Alo Mia, mirëmbërëma më fal nëse të shqetësoj në këtë ore.

- Jo aspak, isha duke ndenjur kot, ç'ndodhi?.

-A mund të vish tek unë, duhet të të tregoj diçka me rëndësi, të lutëm eja sepse nuk ndihem mirë.

-Çfar ndodhi, në rregull tani do të vij.

Pas pak, Mia erdhi. Samanta ia tregoi letrën që ia kishte dërguar zonja Miranda.

-Shiko lexoje se çfar shkruan.

Mia e lexoi dhe u habit.

-Nuk mund ta besoj.

-As unë. Të nesërmen dua të shkoj t'i them që nuk e pranoj një obligim të tillë.

-Mos fol kot Samanta, nuk e sheh se ç' shkruan nuk ka as fëmijë, as familje dhe s'ka kujt t'ia lë trashigimin firmën, prandaj të ka zgjedhur ty?

- Po por.....

-Jo Samanta mendoj se duhet ta pranosh. Nëse shkon e i thua se se pranon, atëherë ajo do mërëzitet shumë, e nëse se udheheq dikush firmën, ajo do shkatërohet. Madje kjo është ëndërra jote, a nuk thoshe edhe unë dua të kem një kompani, ja ku e ke shansin.

-Po ashtu është. Atëherë ç'pret pranoje. Samanta kishte shumë pyetje në kokën e saj dhe nuk dinte se ç'të bënte. Në vazhdim do të shihni vendimin e saj.!

VDEKJA E MIRANDËS

Përgjigja e Samantes ishte po. Ajo mendoj shumë gjatë sepse në një moment paniku njeriu gjithmonë merr vendim të gabuar.

-Ke të drejt Mia, ajo nuk ka askujt t'ia lë kompaninë prandaj me zgjodhi mua. Me të vërtetë unë nuk kam bërë asgjë për atë kompani, por do të bëj shumë gjëra për ta ngritur sa më lartë atë kompani në të ardhmen.

-Ashtu pra, u gëzova shumë që pranove.

-Ëndërra ime ka qenë të kem një kompani, por të kontriboja prej fillimit në të, jo ta kem gati.

-Në rregull, ti vetë e the se do bësh shumë për atë kompani.

- Po ashtu është, faleminderit shumë.

-Mia të mos ishe ti, unë nuk do mund ta zgjidhja këtë problem.

- Mos fol ashtu, ne jemi shoqe.

-Mirë atëherë, tani është vonë dhe nuk të lë të shkosh në shtëpi, tregoj nënës sate se sonte do të flesh këtu.

-Në rregull.

Mia atë natë fjeti te Samanta. Të nesërmen të dyja u zgjuan herët, hëngren mëngjes dhe u bënë gati për punë.

-Mia, unë sot do të vijë më vonë në punë sepse duhet të shkoj tek zonja Miranda.

-Sigurisht në rregull, por dua që edhe unë të vijë ta vizitoj zonjën para se të vdes, u mërzita shumë, është një grua shumë e mirë.

-Sigurisht, eja do të gëzohet shumë kur të të sheh.

Te dyja filluan rrugën për tek shtëpia e zonjes Miranda, ariten shpejt. Kur aritën te shtëpia e sajë, zonja Miranda ishte shtrirë dhe ishte shumë e zbehur, e kolliste.

-Ohhh, mirë se erdhët vajza, gëzohem që iu shoh.

-Si je zonjë?

-Ja siç më shihni.

-Dukesh mirë,- tha Mia.

-Më tregoni si ju shkojnë punët me kursin?

-Shumë mirë, zonja Miranda.

-Samanta, besoj se e ke lexuar letrën që ta dërgova mbrëmë.

-Po e lexova.

-Cila është përgjigja jote?

- Dëgjo zonjë, unë ndjem në siklet sepse unë nuk kam bërë asgjë për ta merituar.

-Karakteri yt i fortë, sjellja jote, një vajzë luftarake, a nuk janë të vlevshme këto siç kam shkruar në letër, ti nuk ke bërë për atë firmë diçka, por do të bësh shumë në të ardhmën, si thua?

-Faleminderit shumë, unë mendova gjerë e gjatë dhe....pranoj.

-Vërtetë më bëhet qejfi që ti do e udhëheqësh atë firmë, besoj se do të bësh shumë gjëra.

- Ua jap fjalën Zonjë.

-Miranda tha fjalët e fundit dhe zemra e sajë pushoi një herë e përgjithmonë.

-Zonja Miranda ju lutem hapni sytë,-tha Samanta duke qarë. Mia thirrre ndihmën e shpejtë.

-Mos tento kotë, ajo vdiq,- tha Mia dhe shpërtheu së qari.

-Nuk ka mundësi.

- Zonjë ju lutem hapni sytë, nuk mund të vdesësh. Miranda vdiq në dorën e Samantës .

Të nesërmen e varosën Mirandën, të gjithë qanin për atë grua të fortë që ishte shembull për të gjithë. Në varim ishte edhe Samanta edhe Mia, të dyja qanin mbi varin e sajë.

-Nuk mund ta pranoj vdekjen e saj më duket si një ëndërr,-tha Samanta.

- As unë s'mund ta besoj, një grua aq e fortë, guximtare e përbiu dheu.

-Ashtu është.

- Por ti nuk do dorzohesh. Ia dhe fjalën Mirandës se nuk do e lësh të bie kompania kurrë, do bëhesh e fortë dhe do ia plotësosh dëshirën e saj.

-Sigurisht që po, jeta më bëri me të fortë mua duke m'i marrë njerëzit që doja më shumë dhe kështu që u bëra edhe me e fortë.

-Tani eja të shkojmë në shtëpi,-tha Mia.

- Të dyja shkuan në shtëpi të pikëlluara për vdekjen e Mirandës.

NË FUND TË TUNELIT NJË DRITË PËR TË GJITHË

Kishin kaluar tre javë pas vdekjes së Mirandës, ndërsa Samanta vendosi që të shkojë të nënshkruaj dokumentet që kompaniatë kaloi në pronësi të sajë. Samanta atë ditë vendosi të shkoj tek vari i Mirandës, kishte marrë edhe një buqet me lule.

-Nuk e kisha menduar ndonjë herë që do arija ëndrën time, falë teje je bërë arsyjeja e një vajzë që ta realizoj ëndrrën e saj. Gjithë jetën do ta kem borxh këtë, por do e paguaj me mund dhe me punë, të premtoj dhe ta siguroj këtë punë. Do e bëj vetëm për ju këtë gjë dhe për ëndrrën time, dua t'ua plotësoj edhe juve dëshirën tuaj të fundit. Mos u brengosni nuk do t'iu bëj të dyshoni, do të jap gjithë mundin tim për atë kompani, sepse ajo ka qenë edhe ëndrra ime që të kem unë kompaninë time.

Ju faleminderit që më besuat mua, rri e qetë në varrin tënd, u priefsh në paqe. Nga varezat Samanta shkoi në shtëpi, bëri një dush, mblodhi veten dhe u bë gati të shkonte të nënshkruante ato letra. Samanta shkoi në kompani i nënshkroi letrat dhe kompania tani më u bë e saj. Samanta në anën tjetër u gëzua sepse ajo e realizoi ëndrrën e saj dhe ishte shumë e lumtur. Tani më të gjithë në kompani e thërisnin Zonjë.

-Zonja Samanta, si mendoni të bejmë një festë për ardhjen tuaj, tha njëri nga puntoret?

- Jo nuk ka nevojë mjafton kaq.

Pas pak erdhi Mia.

- Përshëndetje shoqe, shumë të ngjan ai vend ty, dhe e meriton.

-Faleminderit, më fal që do të lë vetë në kurs por ç'të bejmë.

-Mos u shqetëso, do të punoj shumë që të arrij në nivele më të larta.

-Pa dyshym,-tha Samanta.

Të gjithë e moren atë që e meritonin. Kaluan ca muaj dhe kompania që Samanta udhëheqte u bë më e mira nga të gjitha në Milano. Tani Samanta ishte bërë shumë e famshme për punën e saj, dhe s'kishte njeri që se njihte në Milano. Ndërsa Mia, ajo jo vetëm që udhëheqte kursin, por hapi edhe një galeri për piktura, edhe ajo u bë e famshme dhe e pasur. Shpejt erdhi konkurenca dhe dita e shpalljes së kompanive më të mira. Atë ditë Samanta kishte t'i prezantoi

kolekcionet e saja, gjithashtu edhe kompanitë tjera. Kur ua tregoi kolekcionin Samanta, të gjithë u habitën dhe vendosën që kompanin e Samantes ta vlersoin si, “Kolekzione më të mira që kanë egzistuar në botën e dizajnit”. Samanta e mbajti premtimin. Atë ditë në Milano mbahej një festë për kompaninë. Atë ditë u mbloodhen shumë njerëz, të pranishëm ishin edhe Leonardo, Xhakarta, Rosita, gjithashtu edhe Mateo. Samanta mbajti një fjalim.


-Faleminderoi të gjithë që kishin ndarë kohë që të vinin këtu të festojnë se bashku aritjet e kompanisë. Dëshiroj që të tregoj dhe historin time në disa pika të shkurta. Edhe unë si gjithë të tjerët, isha një vajzë e thjeshtë që ëndronte t’i realizonte ëndrrat e saja. Kur fillova këtë rrugëtim, isha shumë e pafuqishme, por nuk do të thotë mos fuqia të dorëzohesh.

Para meje u paraqitën shumë sfida...i kalova me punë dhe mund. Më përjashtuan edhe nga fakulteti, por përsëri qëndroja në këmbët e mia sepse kisha një familje dhe një shoqëri të vërtetë afër vetes. Pastaj në jetën time u shfaq zonja Miranda,...dhe falë asaj jam këtu para jush.

Desha të them, se nese ju dëshironi të arini atë që doni, duhet të punoni shumë, të luftoni dhe të mos dorëzoheni. Pasi mbajti Samanta fjalimin, të gjithë duartrokitën. Prej atij momenti, Samanta çdo ditë punonte. Kaluan edhe vite të tëra, ajo vendosi të shkoj në Meksikë, të vizitonte varrin e nënës së saj, dhe të shihte Mateon. Kaloj një kohë në Meksikë, ndërsa Leonardo Xhakarta dhe Rosita ishin shpërngulur në Milano, kështu që Samanta i vizitonte gjithmonë ato. Shkonte takonte njerëz që kanë nevojë, madje vazhdoj dhe bursat për të rrinjt sepse dëshironte që të gjithë të arinë ëndërrat e tyre.

Kjo ishte jeta e saj, jeta e saj ishte shumë e bukur pranë të dashurve të saj. Epo miq, Samanta nuk u dorëzua, u përball me shumë sfida u përball edhe me sfidat në familje dhe ariti aty ku ajo deshti. Tani Samanta kishte se çfar të shkruaj në fletoren e saj dhe më në fund rrealizoi atë që deshi. Pra miq, durimi dhe mosdorëzimi e sollën Samantën këtu ku është. Por prisni se nuk mbaron këtu e dini Luna çfar bëri ? Edhe ajo gjeti një shoqe si që janë Samanta dhe Mia . Edhe shoqëria e tyre është shumë e vlerëshme, punuan dhe arritën këtu ku janë dhe ende vazhdojnë të punojnë për të arritur më shumë.

Samanta u bë shembull i të gjithëve, shpresoj të ishte bërë edhe shembull për ju. Këtu miq të dashur mbaron edhe ky kapitull i fundit, shpresoj t'iu ketë pëlqyer, shpresoj se e kuptuat mesazhin e librit! Dhe të gjithë ju që e keni ëndër dizainin ose diçka tjetër kur mos u dorëzoni, pa marrë parasysh sfidat në jetë vazhdoni të punoni me shpresë që një ditë të bëheni atë që dëshironi, pra ta rrealizoni ëndrrën tuaj. Sepse ëndërra për ardhmëri nuk do jetë thjesht një ëndërr por një ditë të bëhet realitet. Dhe një gjë t'iu them, mos i humbisni shpresat kurë dhe besoni në vete sepse ju jeni ato të cilët do e bëni realitet ëndrrën tuaj. Aty ku mendoni se gjithçka mbaron, aty pikërisht gjithçka fillon!!!!



Merita Isaki, është nxënëse në vitin e parë në Shkollën e mesme komunale “Kiril Pejçinoviç ” në Tetovë, bashkëjeton me familjen në fshatin Trebosh. Shkollën fillore e ka kryer në Shfk “Fan Noli” në f. Trebosh. Me krijime letrare në poezi debutoi në faqja e shkollës nga klasa e gjashtë, kurse veproi e parë të sajë me poezi “Ndjenja e realitetit” e ka promovuar më 21 nëntor të vitit 2019, për nder të Festës së Kongresit të Manastirit – Ditës së Alfabetit. Kjo është vepra e dytë e sajë. Ka marrë pjesë në shumë konkurse letrare të organizuar nga institucione të ndryshme komunale e regionale. Është anëtare e Shoqatës së shkrimtarve shqiptar “ Oneum” të Tetovës. Me krijimet poetike të saja është shfaqur edhe në shumë programe shkollore, e manifestime tjera të organizuara në fshat dhe në vende tjera të Maqedonisë dhe në Kosovë. Krijimet e saja në poezi i ka lexuar edhe në emisione të ndryshme televizive lokale, në Shtëpinë e Kongresit të Alfabetit të Gjuhës Shqipe në Manastir dhe shumë manifestime tjera. Ka qenë moderatore e emisionit “Në studio” në Tv Pollog . Është nxënëse e shkëlqyeshme dhe ardhmëria e poetëve të rinj.